



GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Gjykata Supreme e Kosovës
Ap.-Kz. Nr. 89/2010
Prishtinë
26 janar 2011

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës në kolegjin e përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger si Kryetar i kolegjit, Gjyqtarët e EULEX-it Martti Harsia dhe Charles L. Smith III dhe Gjyqtaret e Kosovës Emine Mustafa dhe Nesrin Lushta si anëtare të kolegjit.

Me ndihmën e Zyrtarit Ligjor të EULEX-it Sampsa Hakala dhe Procesmbajtësve ndërkombëtarë Eriona Bitri Brading dhe Mia Mezini si procesmbajtëse dhe Përkthyesit ndërkombëtarë Edmond Laska, Altina Ruli-Williams dhe Biljana Maric.

Në procedurën penale kundër të akuzuarve:

Lati GASHI, gjithashtu i njohur si Komandant "Lata",

Nasir MURTEPI, gjithashtu i njohur si "Dini",

Remzim MUSTAFA, gjithashtu i njohur si "Remi",

Të tre të akuzuarit u dënuan me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P. Nr. 526/05 të datës 02 tetor 2009 për Krime lufte kundër popullatës civile në kundërshtim të nenit 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP RSFJ) si në vijim:

1. **Latif Gashi** fajtor për Krime lufte kundër popullatës civile siç përshkruhet në pikën 5, pikën 8 dhe pikën 14 të aktgjykimit dhe dënohet me burgim në kohëzgjatje prej 6 vitesh. Sipas Nenet 351 paragrafin 1 të Ligjit mbi Procedurën Penale të RSFJ-së (LPP), i akuzuari **Latif Gashi** urdhërohet t'i kompensojë palës së dëmtuar M S dëmet e shkaktuara, të caktuara në shumë prej 5.000,00 (pesë mijë) Euro.
2. **Nazif Mehmeti** fajtor për Krime lufte kundër popullatës civile siç përshkruhet në pikën 5 dhe pikën 8 të aktgjykimit dhe dënohet me burgim në kohëzgjatje prej 3 vitesh.
3. I akuzuari **Rrustem Mustafa** fajtor për Krime lufte kundër popullatës civile siç përshkruhet në pikën 5 dhe pikën 8 të aktgjykimit dhe dënohet me burgim në kohëzgjatje prej 4 vitesh.

Duke vepruar lidhur me ankesat e paraqitura në dobi të të pandehurve **Latif Gashi, Nazif Mehmeti dhe Rrustem Mustafa**, përkatësisht të datave 17, 12 dhe 15 shkurt 2010, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë në lëndën P.Nr. 526/05, të datës 2 tetor 2009.

Duke marrë parasysh përgjigjen e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), të datës 5 mars 2010 dhe mendimin e propozimit të Zyrës së Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPSHK), të datës 15 prill 2010.

Pas mbajtjes së seancës më 25 janar 2011, të hapur për publik dhe në prani të të akuzuarve **Latif Gashi, Nazif Mehmeti dhe Rrustem Mustafa**, Avokatëve mbrojtës **Mirshad Syta, Bajrami Prizreni, Paskal Daj** dhe **Adis Rexha** dhe Kryeprokurorit të EULEX-it Johannes van Vreeswijk, që përfaqëson Zyrën e Prokurorit të Shtetit të Kosovës.

Pas këshillimit të mbajtur më 25 janar 2011, sipas Neneve 384 dhe 385 (1) dhe (3) të LPP-së, publikisht shpall këtë

AKTGJYKIM

Ankesat e paraqitura në dobi të të pandehurve **Latif Gashi, Nazif Mehmeti dhe Rrustem Mustafa** kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë në lëndën P.nr. 526/05, të datës 2 tetor 2009, PRANOHEN PJESËRISHT.

Aktgjykimit i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë në lëndën P.nr. 526/05, të datës 2 tetor 2009, anulohet në lidhje me Pikën 8 të saj dhe me dënimet unike të shqiptuara ndaj secilit të akuzuar. Dënimet e ndara për pikat 5 dhe 14 siç janë përcaktuar nga

gjkata e rigjykimit mbështeten, kurse aktgjykimi i kundërshtuar anulohet sa i përket dënimit unik për secilin të akuzuar. Gjykata e shkallës së parë, pas gjykimit të pikës 8 siç ka udhëzuar Gjykata Supreme, do të përcaktojë dënimet unike në të gjitha pikat.

Lënda kthehet në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim sa i përket pjesës së anuluar të aktgjykimit P.Nr. 526/05.

Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë në lëndën P.nr. 526/05, i datës 2 tetor 2009, vërtetohet në pjesët e tij të mbetura. Ankesat e paraqitura në dobi të të akuzuarve REFUZOHEN.

PËRMBAJTJE

HYRJA DHE DISPOZITIVI	1
ARSYETIMI	
HISTORIA E PROCEDURËS	6
GJETJET E GJYKATËS:	
A. Shkelja substanciale e dispozitave të Procedurës Penale	10
I. Pamjaftueshmëritë Formale dhe Kundërthëniet e Dispozitivit	10
1. Aktgjykimi i shkallës së parë si i tillë dhe pajtueshmëria e tij me Nenin 357 të LPP-së	10
2. Dispozitivi dhe pajtueshmëria e tij me Nenin 357 lidhur me nenin 351 të LPP-së	13
3. Mospërputhjet dhe kundërthëniet e përgjithshme të dispozitivit	16
II. Kundërthëniet përkitazi me Arsyetimet e Aktgjyqimit të shkallës së parë	20
1. Kundërthëniet e pretenduara në mes dispozitivit dhe arsyetimit lidhur me dënimin	20
2. Shkeljet e pretenduara të procedurës penale duke mos përfillur emërtimin ligjor të veprës së identifikuar penale	21
3. Domosdoshmëria për të specifikuar të dhënat personale të secilit civil të lidhur me veprën penale Krime lufte sipas Nenit 142 të KP RSFJ-së	21
4. Zbatimi dhe citimi i gabuar dhe jo i plotë i pretenduar i Nenit 22 të LPP-së në dispozitiv	23
5. Keqinterpretimi i pretenduar i Vendimit të Gjykatës Supreme Ap.-Kz. 139/2004 nga Gjykata e shkallës së parë	25
III. Mungesa e udhëzimeve për të drejtën e paraqitjes së ankesës	30

B. Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike	31
I. Dështimi i pretenduar i Gjykatës së shkallës së parë për t'i krahasuar Kushtet e Jetesës së Popullatës Civile dhe të Paraburgosurve	31
II. Konstatimet mbi Përgjegjësinë Personale të të Akuzuarve, veçanërisht të Latif Gashi	35
1. Pikat 5 dhe 14	36
2. Pika 14 në veçanti: Mungesa e besueshmërisë dhe e përgjegjësisë së dëshmitarëve e gjykuar pozitivisht nga Gjykata e shkallës së parë	40
3. Pika 8	42
III. Dështimi i Gjykatës së shkallës së parë për t'i ndarë Deklaratat e Dëshmitarit '4' nga Shkresat e Lëndës	43
IV. Vërtetimi i gabuar i pretenduar i kohës së shërbimit në UÇK nga i akuzuari Nedim Memogaj si dhe Rolit të tij në Qendrën e Paraburgimit	45
V. Vërtetimi i gabuar i pretenduar i fakteve për shkak të karakterit politik të procedurës penale kundër të akuzuarit Rustem Mustafa lidhur me ekzistimin e Qendrës së Paraburgimit në Llapashticë	46
C. Shkelja substanciale e Ligjit Penal	47
I. Shkeljet e pretenduara të Ligjit Substancial me shpalljen e akuzuarit fajtor	47
II. Arbitrariteti i pretenduar me shqiptimin e Kërkesës për Kompensim Latif Gashi	48
D. Vendimi mbi Dënimin	49
E. Përfundimi i Gjykatës Supreme të Kosovës	52

ARSYETIMI

Historia e Procedurës

1. Më 19 nëntor 2002, në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë është ngritur aktakuza kundër tre të akuzuarve si dhe kundër tani të ndjerit **Naim Kallaku** in the.

Aktakuza me pas është ndryshuar me 4 Shkurt dhe 30 Qershor 2003. Sipas aktakuzës së ndryshuar, të akuzuarit janë gjykuar për 14 pika të ndryshme të aktakuzës, me të cilat janë akuzuar vepër penale Krime Luftë kundër Popullatës Civile, në shkelje të nenit 142 të KPRSFJ – së, ligji i aplikueshëm në procedurë sipas Rregullores 1999/24 të lëshuar nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/59.

2. Shqyrtimi gjyqësor në shkallën e parë është mbajtur përpara Gjykatës së Qarkut në Prishtinë e cila, me vendimin e saj të datës 16 korrik 2003, ka hedhur poshtë pikat 4, 6, 7, 10 dhe 13 të aktakuzës në total si dhe akuzat nga pikat 1 dhe 11 të aktakuzës; akuzat kundër **Latif Gashi**. Akuzat për trajtim çnjerëzor, rrahje dhe torturime të civileve që pretendohet të jenë kryer në qendrat e paraburgimit në Majac dhe Potok nga pikat 5 dhe 8 të aktakuzës gjithashtu janë refuzuar, si dhe janë refuzuar akuza nga pika 12 kundër **Nazif Mehmetit** dhe akuza nga pika 14 kundër **Nazif Mehmetit** dhe **Rustem Mustafës**.

Me vendimin e lartpërmendur, të akuzuarit janë shpallur fajtorë për veprën penale Krime Luftë kundër Popullatës Civile, sa i përket akuzave të mbetura. Si pasojë, **Latif Gashi** është dënuar me 10 vjet burgim, **Nazif Mehmeti** me 13 vjet burgim dhe **Rustem Mustafa** me 17 vjet burgim.

3. Avokatet mbrojtës të tre të akuzuarve kanë paraqitur ankesë kundër dënimit, duke kundërshtuar të gjitha pikat e aktakuzës për të cilat klientët e tyre janë shpallur fajtorë; Prokurori ka paraqitur ankese vetëm sa i përket kohëzgjatjes së dënimit të cilin trupit gjykues e ka shpallur kundër **Latif Gashi**.

4. Gjykata Supreme, me vendimin e saj të datës 21 korrik 2005 (Ap. – Kz. 139/2004), më tej e ka zvogëluar shtrirjen e aktakuzës “duke anuluar në tërësi” akuzat: 1, 2, 3 dhe 12 (të gjitha në lidhje me paraburgimin e paligjshëm dhe arrestimin), dhe duke i liruar të akuzuarit nga pika 11 e aktakuzës sepse pretendimi faktik nuk ishte vërtetuar “përtej dyshimit të arsyeshëm”. Megjithatë, dispozitivi i vendimit përkatës të Gjykatës Supreme thotë se “aktgjykimi nr. 425/01 [...] anulohet dhe pezullohet në tërësi dhe lënda [...] kthehet për rigjykim”. Prandaj, pikat e mbetura të aktakuzës janë kthyer prapa në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim, në pajtim me nenin 381 të LPP-së. Në kontekst, Gjykata Supreme e Kosovës gjithashtu i ka liruar të akuzuarit nga paraburgimi dhe ka urdhëruar masa kufizuese (të cilat përfundimisht i ka hequr Kryetari i trupit gjykues i

Gjykatës së shkallës së parë të rigjykimit me dy aktvendime pasuese të datës 28 prill dhe 15 korrik 2009

5. Gjykata e Qarkut në Prishtinë (P 526/05) konsideroi se duhej të mbahej një shqyrtim gjyqësor i ri lidhur me pikat e mbetura të aktakuzës 5, 8, 9 dhe 14, edhe pse faktet e referuara në pikën 8 të aktakuzës tanimë ishin vlerësuar drejt dhe ishin vërtetuar nga Gjykata Supreme në vendimin e saj (Ap.-Kz. 139/2004) dhe e kufizoi veten, lidhur me këtë pikë specifike të aktakuzës, vetëm në dënimin.

6. më 14 prill 2009, Prokurori i PSRK-së i EULEX-it ka ngritur një aktakuzë të ndryshuar kundër të tre të akuzuarve në të cilën pika e vetme e aktakuzës për Krime Luftë kundër Popullatës Civile është ndarë në tri nënpika që përfshijnë pikat 4, 5, 6, 7, 8, 9, 11, 13 dhe 14 të aktakuzës së parë. Avokatët mbrojtës kanë kundërshtuar aktakuzën, duke parashtruar se aktakuza e ndryshuar përfshin akuza të cilat më nuk janë pjesë e *thema decidendi*.

7. Aktakuza e ndryshuar u refuzua me vendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të datës 08 korrik 2009 dhe, si pasojë, aktakuza e ndryshuar e datës 30 qershor 2003 u ishte marrë për bazë për rigjykim përkritazi me pikat 5, 8, 9 dhe 14 të aktakuzës.

8. Rigjykimi ka filluar më 7 Korrik 2009 në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë përpara trupit gjykues në përbërje të përzier EULEX/Kosovarë në praninë e të akuzuarve dhe avokatëve të tyre mbrojtës, dhe pa praninë e asnjërës prej palëve të dëmtuara të cilat janë thirrur në mënyrë te duhur,

9. Gjykata e shkallës së parë ka mbajtur gjithsej 12 seanca në mes 07 korrikut dhe 02 tetorit 2009, brenda të cilave ishin lexuar aktakuza dhe ndryshimet e saj në pajtim me Nenin 390 të LPP-së si dhe vendimet mbi refuzimin e aktakuzës së ndryshuar, tre të akuzuarit janë marrë në pyetje dhe ishin dëgjuar këta dëshmitarë: K. H. G. Z., S. G. R. E., K. P., N. G. N. I., K. K., M. L., I. S., A. M. T. A. V. J. F. M., F. S., M. S. dhe R. B. të gjithë dëshmitarët i vërtetuan deklaratat e tyre të dhëna para Gjyqtarit Hetues më 2002 ose para Trupit gjykues të shkallës së parë në vitin 2003 dhe sipas kërkesës u përgjigjën në disa pyetje shtesë.

Përveç kësaj, më 18 Shtator 2009, Gjykata ka shënuar në procesverbal si prova deklaratat e dëshmitarit "Q" të dhëna përpara gjykatësit hetues më 01 dhe 02 shkurt 2002, deklaratat e dëshmitarit S. B., të dhëna përpara gjykatësit hetues më 18 korrik 2002; deklaratat e dëshmitarit "4" të dhëna përpara gjykatësit hetues më 18 tetor 2002 dhe procesverbali i dëshmisë së tij të dhëna në shqyrtimin gjyqësor më 20 dhe 21 mars 2003; si dhe deklarata e dëshmitarit V. V. (fillimisht dëshmitari "H") e dhëna përpara gjykatësit hetues më 6 shkurt 2002 dhe procesverbali i dëshmisë së tij të dhëna në shqyrtimin gjyqësor më 5 mars 2003. Përveç kësaj, Gjykata pranoi dhe rishikoi prova tashme të ofruara gjatë gjykimit të parë dhe të parashtruara në rigjykim nga ana e

Prokurorit siç janë paraqitur me pare: Prova nr. 4, “libri ngjyre kafe”; Prova 33, raporti i OSBE-se me titullin “si është pare është treguar”; Provat 26 dhe 27 (dosjet mjekësore te M. S.) dhe procesverbali i Këqyrjes së Vendit, që është kryer gjate shqyrtimit të parë gjyqësor më 27 Qershor 2003 dhe fotografitë e bashkangjitura, në veçanti fotografitë 7, 8 dhe 9. Gjykata e shkallës së parë dëgjoi fjalimet përfundimtare nga Prokurori Publik, Avokatët mbrojtës të të akuzuarve dhe vetë të akuzuarve dhe shpalli Aktgjykimin më 02 tetor 2009, kur u urdhërua edhe arrestimi i të akuzuarit **Lutfi Gashi** sipas Nenit 353 paragrafi 1 dhe 7 i LPP-së.

10. Gjatë fjalimit të tij të fundit, Prokurori i PSRK-së tërhoqi akuzën e pikës 9 të aktakuzës së ndryshuar të datës 30 shtator 2003, lidhur me rrahjen dhe torturimin e pretenduar të qytetarëve Shqiptarë të Kosovës të burgosur në mënyrë joligjore në qendrën e paraburgimit në Koliq.

11. Më 02 tetor 2009 Gjykata e rigjykimin e shkallës së parë, Gjykata e Qarkut në Prishtinë me Aktgjykimin P 526/05 shpalli të akuzuarit fajtorë si në vijim:

- Të akuzuarin **Lutfi Gashi** për vepër penale **Krime Luftë kundër Popullatës Civile** (sipas Nenit 142 lidhur me Nenet 22, 24, 26 dhe 30 të KP RSFJ-së), siç është përshkruar në Pikën 5, Pikën 8 dhe Pikën 14 të aktakuzës së ndryshuar të datës 30 qershor 2003 dhe dënohet me gjashtë (6) vjet burgim; përveç kësaj, Gjykata e urdhëroi atë të kompensojë palën e dëmtuar M. S. për dëmin e shkaktuar në shumën prej pesë mijë (5000,-) €.
- Të akuzuarit **Nazif Mehmeti** dhe **Rustem Mustafa** për vepër penale **Krime Luftë kundër Popullatës Civile** (sipas Nenit 142 lidhur me Nenet 22, 24, 26 dhe 30 të KP RSFJ-së), siç është përshkruar në Pikën 5 dhe Pikën 8 të aktakuzës së ndryshuar të datës 30 qershor 2003 dhe dënohen, **Nazif Mehmeti** me tri (3) vjet dhe **Rustem Mustafa** me katër (4) vjet burg.

Me Aktgjykimin e njëjtë, Gjykata e shkallës së parë urdhëroi të tre të akuzuarit të mbulojnë shpenzimet e procedurës penale sipas Nenit 98 paragrafit 1 dhe 2 të LPP-së, me përjashtim të shpenzimeve të përkthimit dhe interpretimit.

12. Me Aktvendim të veçantë, sipas Nenit 353 paragrafit 1 të LPP-së, Gjykata e shkallës së parë shqiptoi masën e paraburgimit ndaj **Lutfi Gashi** deri sa aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

13. Aktgjykimi i shkallës së parë iu dorëzua **Lutfi Gashi** personalisht më 3 shkurt 2010, **Nazif Mehmeti** më 4 shkurt 2010 dhe **Rustem Mustafa** më 3 shkurt 2010. Avokatët mbrojtës të tre të akuzuarve paraqitën ankesat e tyre brenda afatit të përcaktuar kohor: Mbrojtja e **Lutfi Gashi** paraqiti ankesën më 18 shkurt 2010, Mbrojtja e **Nazif Mehmeti** më 15 shkurt 2010 dhe Mbrojtja e **Rustem Mustafa** më 16 shkurt 2010. Pretendohej se Aktgjykimi përmban shkelej esenciale të procedurës penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të kodit penal dhe se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarve duhej të kundërshtohej. Prandaj, Avokatët mbrojtës kërkuan si në vijim:

- **Avokatët mbrojtës të Latif Gashit**, që Gjykata Supreme e Kosovës të ndryshojë – me miratimin e ankesës së tyre – Aktgjykimin e shkallës së parë duke liruar Latif Gashin nga të gjitha akuzat
- **Avokati mbrojtës i Nazif Mehmetit dhe Avokati mbrojtës i Rustem Mujafit**, që Gjykata Supreme e Kosovës të anulojë Aktgjykimin e ankimuar dhe të kthejë lëndën prapa në Gjykatën e shkallës së parë për rigjykim, ose të ndryshojë atë duke liruar Nazif Mehmetin dhe Rustem Mujafin nga të gjitha akuzat.

14. **Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PRSK)**, me përgjigjen e datës 05 mars 2010 dhe të regjistruar në Shkrimoren e Gjykatës Supreme të Kosovës në sitën e njëjtë kundërshtoi ankesat të janë jomeritore dhe të pabazuara. Prokurori Special propozoi të refuzohen ankesat e tre të akuzuarve dhe të vërtetohet në tërësi Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë nr. 526/05 i datës 02 tetor 2009.

15. **Më 13 maj 2010 Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPShK)** paraqiti një mendim më datë 15 prill 2010 sipas Nenit 370 paragrafit 1 të LPP-së dhe propozoi:

- 1) **si kërkesë kryesore**, të refuzohen ankesat e Avokatëve mbrojtës të të akuzuarve Latif Gashit, Nazif Mehmeti dhe Rustem Mujafa, të parashtruara kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P.Nr. 526/05 të datës 02 tetor 2009 dhe të vërtetohet Aktgjykimi i kundërshtuar dhe
- 2) **si kërkesë suplementare**, në rast se Gjykata Supreme konsideron se gjendja faktike nuk ishte vërtetuar drejt përkitazi me disa nga faktet e referuara në pikat e aktakuzës për të cilat të pandehurit ishin dënuar,
 - a) të merret parasysh hapja e shqyrtimit në përputhje me bashkimin e dy Neneve 372 paragrafi 1 dhe 373 paragrafi 1 të LPP-së, me qëllim të qartësimit ku është e nevojshme, me mbledhjen e dëshmimeve përkatëse shtesë (duke përfshirë edhe dëgjimin e dëshmitarëve eventualë) faktet që kërkojnë qartësim dhe kështu të shmangen vonesat e panevojshme; ose
 - b) të pezullohet Aktgjykimi i kundërshtuar (pjesërisht apo tërësisht) dhe lënda të kthehet në rigjykim në përputhje me bashkimin e dy Neneve 381 paragrafi 1 dhe 385 paragrafi 1 dhe 3 të LPP-së, duke ofruar udhëzime dhe drejtime të qarta për Gjykatën e shkallës së parë, në asnjë mënyrë duke mos vendosur për lirimin e të pandehurve në bazë të arsyeve se një gjykim tjetër do të ishte thyerje e të drejtave të të pandehurve për tu gjykuar brenda një kohe të arsyeshme dhe duke mos i zbatuar përfundimet e njëjta të miratuara në vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës (Ap.-Kz. nr. 1/2009, të datës 07 tetor 2009), tani i nënshtruar një Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga ZPShK-ja më 26 mars 2010.

- 3) **si kërkesë alternative suplementare**, në rast se Gjykata Supreme vërteton ekzistimin e shkeljeve esenciale të parimeve të procedurës penale ose Vendimi i Gjykatës Supreme Ap.-Kz. 139/2004 anulohet, në tërësinë e vet substanciale, Aktgjykimi Ap.-Kz. 139/2004 vepron në përputhje me Nenin 385 paragrafët 1 dhe 3 të LPP-së dhe anulon, pjesërisht ose tërësisht, Aktgjykimin P 526/05 dhe cakton një gjykim të ri para gjykatës me kompetencën e parë, me kërkesat e njëjta të përmendura në pikën 2) nën b) lidhur me domosdoshmërinë e dhënies së udhëzimeve dhe drejtimeve të qarta për Gjykatën e shkallës së parë dhe lidhur me mos zbatimin e parimeve të njëjta dhe të disa përfundimeve të njëjta të arritura në vendimin e Gjykatës Supreme Ap.-Kz. nr. 1/2009.

GJETJET E GJYKATËS

A. Shkelje substanciale të dispozitave të Procedurës Penale

I. Pamjaftueshmëritë Formale dhe Kundërthëniet e Dispozitivit

16. Avokatët mbrojtës të tre të akuzuarve, pjesërisht me arsyetim të ndryshëm, kanë theksuar se dispozitivi i **Aktgjykimit të shkallës së parë shkel Nenin 364 paragrafin 1, nën-paragrafin 11 të LPP-së** (ekuivalent me nenin 403 paragrafin 1 pika (12) e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK)).

17. Gjykata Supreme e Kosovës, pas analizës me kujdes të Aktgjykimit të shkallës së parë në krahasim me ligjin në fuqi, konstaton si në vijim:

18. Edhe pse disa nga kushtet e Nenit 357 të LPP-së nuk janë plotësuar tërësisht me aktgjykimin e kundërshtuar të shkallës së parë, këto mangësi nuk e arsyetojnë ndryshimin ose anulimin e Aktgjykimit në fjalë, pasi që shkeljet e pretenduara nuk kanë ndikuar në marrjen e një aktgjykimi të ligjshëm dhe të drejtë siç kërkon Neni 364 paragrafi 1, nënparagrafi 11 i LPP-së.

1. Aktgjykimi i shkallës së parë si i tillë dhe përputhja e tij me Nenin 357 të LPP-së

19. Sipas Mbrojtjes, Aktgjykimi i shkallës së parë si i tillë fare nuk përmban dispozitiv. Aktgjykimi përkatësisht lexon “Dispozitiv” në vend të “Aktgjykim” dhe përveç kësaj vendimit të ankimuar i mungon shumica e elementeve të Nenit 357 të LPP-së, edhe pse kjo e fundit është e obligueshme. Neni 357 i LPP-së do të shkelet, pasi që dispozitivit i mungojnë të dhënat e domosdoshme të të akuzuarve siç parashihet me Nenin 357 paragrafin 4 lidhur me Nenin 351 të LPP-së.

20. Përkitazi më këtë, Gjykata Supreme e Kosovës konstatoi se sipas procesverbalit të Shqyrtimit Gjyqësor të datës 02 tetor 2009, në të cilin u shpall Aktgjykimi i kundërshtuar,

nuk ekzistojnë mospërputhje në mes të aktgjykimit me shkrim dhe aktgjykimit siç ishte shpallur në seancë. Prandaj, kushti përkatës i Nenit 357 paragrafit 1 të LPP-së është plotësuar.

21. Për më tepër, Aktgjykimi i shkallës së parë në përgjithësi është strukturuar në përputhje me Nenin 357 paragrafin 1 të LPP-së. Në përmbajtjen e tij ka një hyrje, një dispozitiv dhe një sqarim (arsyetim). Është i strukturuar si në vijim:

- Hyrja f. 1
- Dispozitivi f. 2-4
- Arsyetimi f. 4-30
 - Historia e Procedurës f. 4-7
 - Gjetjet Ligjore f. 7-20
 - Analiza e pikave të aktakuzës (përkatësisht 5, 8, 9 dhe 14) f. 21-30
- Dënimi (si pjesë e arsyetimit) f. 30-31

22. Në këtë fazë, vlen të përmendet se hyrja e Aktgjykimit përmban të gjitha informatat e nevojshme siç kërkohet nga Neni 357 paragrafi 2 i LPP-së.

Neni 357 paragrafi 2 i LPP-së përcakton si në vijim:

Hyrja e aktgjykimit përmban; shënimin se aktgjykimi jepet në emrin e popullit, emrin e gjykatës, emrin dhe mbiemrin e kryetarit dhe anëtarëve të kolegjit dhe të procesmbajtësit, emrin dhe mbiemrin e të akuzuarit, veprën penale për të cilën është akuzuar dhe a ka qenë i pranishëm në seancën kryesore, ditën e seancës kryesore dhe a ka qenë seanca me dyer të hapura, emrin dhe mbiemrin e prokurorit, mbrojtësit, të përfaqësuesit ligjor dhe të përfaqësuesit me prokurorë, që kanë qenë të pranishëm në seancën kryesore, dhe ditën e shpalljes së aktgjykimit të dhënë.

Aktgjykimi i shkallës së parë është dhënë “Në Emër të Popullit”, ky formulim si titull i tërë Aktgjykimit, njofton se aktgjykimi është dhënë nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë, përmban emrin dhe mbiemrin e të dyve, Kryetarit të kolegjit Francesco Florit dhe anëtarëve të kolegjit, Gjyqtarit të EULEX-it Tron Gunderson dhe Gjyqtarit të Kosovës Rahman Retkoceri dhe po ashtu Procesmbajtësi përmendet me emër të plotë, ku shkruan se kolegji është “*asistuar nga procesmbajtësi i nënshkruar më poshtë*”, emri ti të cilit, Francesco Caruso, nuk është në hyrje, por jepet në fund të Aktgjykimit (f. 32 e versionit në gjuhën Angleze). Gjykata Supreme konstaton se – edhe pse ky aspekt nuk është në përputhje me kushtet e Nenit 357 paragrafi 2 të LPP-së – kjo rrethanë nuk e rrezikon vlefshmërinë e Aktgjykimit, pasi që Aktgjykimi duhet të lexohet në tërësi dhe në fund përmban emrin e plotë të Procesmbajtësit.

Hyrja përveç kësaj përmban emrin dhe mbiemrin e të tre të akuzuarve, të cilët janë **L. G.**, **Nazif Mehmeti** dhe **Rustem Mustafa**, edhe pse veprat penale për të cilat janë akuzuar, nuk përmenden në hyrje. Megjithatë, prapë kjo nuk e bën Aktgjykimin të pavlefshëm pasi që akuzat përkatëse janë të dhëna hollësisht në dispozitiv (f. 2 e versionit në gjuhën Angleze) edhe duke marrë parasysh se Aktgjykimi duhet të lexohet në tërësi.

Aktgjykimi i shkallës së parë në hyrjen e tij gjithashtu vëren faktin se të pandehurit ishin të pranishëm gjatë shqyrtimit gjyqësor pasi që jep informata lidhur me datën e shqyrtimit gjyqësor, i cili në seancën e tij të fundit ka filluar më 1 tetor 2009, dhe në datën kur është shpallur aktgjykimi më 2 tetor 2009.

Hyrja e aktgjykimit në të vërtetë nuk përmban emrin dhe mbiemrin e prokurorit dhe të avokatëve mbrojtës, e as nuk jep informata nëse shqyrtimi gjyqësor është mbajtur publikisht siç kërkohet me nenin 357 paragrafin 2 të LPK-së.

Sidoqoftë, sa i përket prokurorit dhe avokatëve mbrojtës, aktgjykimi në hyrjen e tij thotë: *“ pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, në prani të prokurorit publik, të akuzuarve dhe avokatëve të tyre mbrojtës;...”* (faqe 1 e versionit në gjuhën angleze).

Nënkuptohet se aktgjykimi është bazuar në seancat e shqyrtimit gjyqësor siç është reflektuar në procesverbal.

Në të gjitha procesverbalet e 12 seancave të shqyrtimit gjyqësor, i cili ka filluar më 7, 8, 9, 10 dhe 15 korrik 2009, 9, 10, 11, 15, 18 dhe 30 shtator 2009 dhe më 2 tetor 2009, emrat e avokatëve mbrojtës mund të lexohen si në vijim:

- **Bajram Dima** dhe **Mehid Sylja** për **L. G.**
- **Aziz Roshaj** për **Rustem Mustafën**
- **Fozije Balaj** për **Nazif Mehmetin**

Gjithashtu në të gjitha procesverbalet e lartpërmendura mund të lexohet që *“seanca ... [ka qenë] ... publike”*, (gjithnjë në faqen 1 në versionin në gjuhën angleze).

Pikëpamjet e lartpërmendura të Gjykatës Supreme të Kosovës mbështeten gjithashtu nga komentaret përkatës të nenit 357 të LPP-së, i cili përcakton si në vijim:

“ hyrja e aktgjykimit është, në vetvete, dhe në bazë të përmbajtjes së tij të caktuar, një pjesë specifike e aktgjykimit sepse në mënyrë objektive identifikon agjentët-pjesëmarrësit në procedurë në shqyrtimin gjyqësor, lëndën dhe kohën e gjyqimit. Në këtë, duhet pasur parasysh faktin se dispozitat e nenit 364, paragrafi 1, pika 11, i referohen vetëm hyrjes së aktgjykimit, që do të thotë se një mangësi e vogël në hyrje të aktgjykimit nuk do të përbënte ndonjë shkelje të rëndësishme të dispozitave të procedurës penale të nenit 364” (Branko Petriq, Komentari mbi Ligjin e procedurës Penale 1986; botimi i 2-të, Gazeta Zyrtare e RSFJ-së; Beograd: Neni 357; Pika II.3.).

23. Prandaj, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se aktgjykimi i shkallës së parë në hyrjen e tij përmban disa dobësi formale, të cilat përndryshe nuk e bëjnë aktgjykimin e pavlefshëm, pasi që në fakt nga procesverbali mund të kuptohet se nuk është bërë asnjë gabim formal në lidhje me këtë.

2. Dispozitivi dhe përputhja e tij me nenin 357 në lidhje me nenin 351 të LPP-së

24. Mbrojtja ka theksuar se neni 357 i LPP-së është shkelur, pasi që dispozitivit i mungojnë të dhënat e domosdoshme të të akuzuarit siç parashihet me nenin 357 paragrafin 4 në lidhje me nenin 351 të LPP-së. Për më tepër, dispozitivi nuk e përshkruan fare akuzën nga pika 9 e aktgjykimit kundër **Latif Gashit** dhe **Rrustem Mujafes**, dhe arsyet pse është refuzuar.

25. Gjykata Supreme e Kosovës gjen se dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë i përmbush së paku kushtet minimale të ligjit dhe se në mënyrë strukturore dhe substanciale është i mjaftueshëm. Deri më tani, neni 357 paragrafët 3 dhe 4 në lidhje me nenet 218 dhe 351 të LPP-së janë vendimtar lidhur me formën dhe përmbajtjen e dispozitivit.

Neni 357 paragrafët 3 dhe 4 përcaktojnë si në vijim:

(3) Dispozitivi i aktgjykimit përmban të dhënat personale mbi të akuzuarin (neni 218 paragrafi 1) dhe vendimin me të cilin i akuzuari shpallet fajtor për veprën për të cilën është akuzuar ose me të cilin lirohet nga akuza për atë veprë ose me të cilin akuza refuzohet.

(4) Kur i akuzuari është shpallur fajtor, dhënia e aktgjykimit duhet të përfshijë të dhënat e nevojshme të parashikuara me nenin 351 të këtij ligji, dhe nëse lirohet nga akuza ose akuza refuzohet, dispozitivi i aktgjykimit duhet patjetër të përfshijë përshkrimin e veprës për të cilën akuzohet dhe vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesës pronësore nëse një e tillë është dorëzuar.

Neni 218 paragrafi 1 i LPP-së për aq sa lidhet me lëndën në fjalë, shkruan si në vijim:

(1) ... [I] pandehuri...do të pyetet për emrin dhe mbiemrin, llogarin kur e ka, emrin dhe mbiemrin e prindërve, mbiemrin e gjinisë së nënës, ku ka lindur, ku banon, ditën muajin dhe vitin e lindjes, çfarë kombësie ka dhe shtetas i kujt është, profesionin, cilat janë rrethanat familjare, a din shkrim e lexim, cilën shkollë e ka kryer,...a ka qenë i dënuar...

Neni 351 i LPP-së, për aq sa lidhet me këtë, përcakton si në vijim:

Në aktgjykimin me të cilin i akuzuari shpallet fajtorë gjykata do të japë:

- 1) për cilën veprë shpallet fajtor, me shënimin e fakteve dhe të rrethanave që përbëjnë karakteristikat e veprës penale si dhe të atyre nga të cilat varet aplikimi i dispozitës së caktuar të ligjit penal;
- 2) emri ligjor i veprës penale dhe dispozitat e ligjit penal që janë aplikuar;
- 3) me cilin dënim i akuzuari dënohet ose sipas dispozitave të ligjit penal lirohet nga dënimi;
- 4) ...
- 5) ...
- 6) vendimin mbi llogaritjen e paraburgimit ose mbi dënimin e vuajtur;
- 7) vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale, mbi kërkesën pasurore-juridike si dhe mbi faktin se aktgjykimi me formë të prerë duhet shpallë nëpërmjet shtypit, radios ose televizionit;
- 8) ...

26. Gjykata Supreme e Kosovës gjen se të gjitha kushtet e domosdoshme të ligjit lidhur me dispozitivin siç janë cekur më parë janë përmbushur nga aktgjykimi i shkallës së parë dhe në bazë të informatave të dhëna, identifikimi i të akzuarit pa asnjë dyshim është i mundur.

27. Në përgjithësi, duhet të përmendet se dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë si i tillë në fakt nuk përmban të dhënat personale përkatëse të tre të akzuarve siç kërkohet me nenin 357 paragrafin 3 në lidhje me nenin 218 paragrafin 1 të LPP-së. Sidoqoftë, këto të dhëna janë dhënë në detaje të plota në hyrjen e aktgjykimit. Hyrja përmend emrin dhe mbiemrin si dhe nofkat e tre të akzuarve, p.sh. **Lutf Gani**, i njohur si Komandant "**L...**", **N...** **M...**, i njohur si "**D...**" dhe **Rustem Mustafa**, i njohur si "**R...**". Përmenden emrat e të dy prindërve të secilit të pandehur (edhe pse jo mbiemrat e gjinisë së nënave të tyre) vendi dhe data e lindjes së tre të akzuarve si dhe adresat/vendbanimet e tyre, të cilat në kohën e shqyrtimit gjyqësor në shkallën e parë kanë qenë adresa private ose qendra e paraburgimit. Kombësia dhe shtetësia e tyre siç është dhënë "me kombësi shqiptarë të Kosovës" në secilën lëndë dhe gjithashtu profesioni përkatës dhe gjendja familjare si dhe faktin se asnjëri prej tyre nuk ka qenë i dënuar më parë, janë përmendur në hyrje. Për detaje, i referohet faqes 1 të aktgjykimit të shkallës së parë (versionit në gjuhën angleze) dhe të dhënave personale të të akzuarve siç janë përmendur në aktgjykimin e Gjykatës Supreme. Duke e pasur parasysh se aktgjykimi duhet të lexohet si një dokument unik, kushtet përkatëse të ligjit janë përmbushur nga aktgjykimi në fjalë.

Në veçanti ai nuk mund të jetë *ratio legis* i dispozitave përkatëse të ligjit të aplikueshëm të procedurës penale, e që në lëndën në fjalë është LPP-ja, të citohen faktet disa herë në aktgjykim, posaçërisht në hyrje, në dispozitiv dhe ndoshta përsëri në arsyetim të aktgjykimit, vetëm për arsye formale ose të përfshihen pjesë të mëdha dhe të domosdoshme të një pjese të aktgjykimit edhe në pjesën tjetër të aktgjykimit të njëjtë, në lëndën në fjalë në dispozitiv. Derisa dispozitivi në fjalë është i qartë dhe i kuptueshëm, aktgjykimi duhet të konsiderohet si një dokument unik i përbërë nga tri pjesë si hyrja,

dispozitiv dhe arsyetimi (neni 357 paragrafi 1 i LPP-së). Pasi që dispozitivi është pjesë integrale (dhe më vendimtarja) e aktgjykimit ai duhet të lexohet dhe interpretohet në lidhje me të gjitha pjesët tjera të aktgjykimit.

28. Vlen të përmendet se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk jep ndonjë informatë lidhur me pyetjen nëse të akuzuarit dinë shkrim dhe lexim. Sidoqoftë, është theksuar se që të tret kanë diploma të fakultetit juridik të Universitetit të Prishtinës dhe prandaj mund të konsiderohet se dinë shkrim dhe lexim.

29. Gjithashtu, mbiemrat e gjinisë së nënave të tre të akuzuarve nuk janë përmendur në aktgjykim. Sidoqoftë, qëllimi i këtij kushti ligjor është që pa asnjë dyshim të sigurohet identiteti i të akuzuarve. Pasi që nuk kemi të bëjmë me këtë të fundit, por identiteti i të tre të akuzuarve është vërtetuar në mënyrë të qartë gjatë hyrjes së aktgjykimit të shkallës së parë, kjo mungesë e informacioneve nuk mund të ketë ndonjë efekt në vlefshmërinë e aktgjykimit.

30. Përfundimisht, vlen të përmendet se asnjë informatë nuk është dhënë mbi shërbimin ushtarak dhe dekorimet e mundshme të tre të akuzuarve. Përkundër pyetjes nëse këto kushte të LPP-së janë akoma të azhurnuara dhe relevante për gjetjen e dënimit të duhur, funksionet ushtarake e tre të akuzuarve, deri në një masë të caktuar, si të tilla janë objekt i lëndës dhe analizave të bëra nga gjykata e shkallës së parë. Prandaj, ato janë diskutuar shumë gjatë arsyetimit të aktgjykimit. Sidoqoftë, kjo mungesë e informacioneve nuk mund të ketë ndonjë ndikim në vlefshmërinë e aktgjykimit në fjalë.

31. Gjykata Supreme e Kosovës, për më tepër gjen se vendimi i cili shpall të pandehurit fajtorë për veprat penale për të cilat akuzohen, siç kërkohet me nenin 357 paragrafin 3 të LPP-së janë përmendur në detaje në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë (faqe 2 e versionit në gjuhën angleze). Pasi që është përmendur se për cilat pika të aktakuzës të akuzuarit janë shpallur fajtorë, pikat përkatëse të aktakuzës në lidhje me të akuzuarit janë cituar në dispozitiv.

32. Për më tepër, aktgjykimi i shkallës së parë në dispozitivin e tij vendos në mënyrë të drejtë mbi refuzimin e Pikës 9 të aktakuzës me të cilën **Luft Gashi** dhe **Restem Mustafa** janë akuzuar (faqe 3 e versionit në gjuhën angleze). Vendimi është marrë në bazë të tërheqjes së pikës përkatëse nga Prokurori publik. Prandaj, dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë gjithashtu përmbush kushtin e dytë të nenit 357 paragrafit 3 të LPP-së.

33. Përfundimisht, Gjykata Supreme e Kosovës gjithashtu gjen se dispozitivi i aktgjykimit përfshinë të dhënat e domosdoshme të referuara në nenin 351 të LPP-së siç kërkohet me nenin 357 paragrafin 4 të LPP-së. I shpall veprat penale për të cilat të akuzuarit janë shpallur fajtorë me citimin e fakteve dhe rrethanave të cilat përbëjnë elementet e veprës penale si dhe të atyre nga të cilat varet zbatimi i ligjit penal (neni 142 në lidhje me nenet 22, 24, 26 dhe 30 të KP të RSFJ-së). Deri më tani, i referohet asaj që është theksuar më parë, duke thënë se aktgjykimi i shkallës së parë i citon në detaje pikat përkatëse të aktakuzës (A. I. 2., faqe13 pika 31). Emri ligjor i veprave penale përkatëse

është dhënë si “*Krime të luftës kundër civilëve*”, kurse emri i saktë i përdorur në KP të RSFJ-së është “*Krime të luftës kundër popullatës civile*”, gjë që megjithatë nuk përbën shkelje procedurale me ndonjë ndikim në vlefshmërinë e dënimit.

34. Përfundimisht, dënimi me të cilin tre të akuzuarit janë dënuar është përmendur në mënyrë të ndarë për secilin nga tre të akuzuarit në faqen 3 të aktgjykimit të shkallës së parë (versioni në gjuhën angleze).

35. E fundit por jo më pak e rëndësishme, dispozitivi gjithashtu përmban një vendim mbi llogaritjen e paraburgimit dhe vendos mbi shpenzimet e procedurës penale (faqe 3 e versionit në gjuhën angleze), si dhe mbi kërkesën pasurore-juridike të palës së dëmtuar M S (faqe 4 e versionit në gjuhën angleze).

3. Mospërputhjet e përgjithshme dhe kontradiktat e dispozitivit

36. Mbrojtja ka pretenduar se dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë është i pakuptueshëm dhe i paqëndrueshëm pasi që **nuk ka mundur të kuptohet nëse të akuzuarit janë dënuar vetëm për një veprë penale unike Krime të luftës kundër civilëve, apo për më shumë prej tyre**. Në veçanti, është në kundërshtim me nenin 48 të KP të RSFJ-së. Prandaj, neni 364 paragrafi 11 i LPP-së është shkelur.

37. Referencë i është nenit 364 paragrafi 11 të LPP-së në lidhje me nenin 357 paragrafin 5 të LPP-së dhe – materialisht – nenin 48 të KP të RSFJ-së. Gjykata Supreme e Kosovës gjen se pjesës së dënimit në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë (faqe 3 e versionit në gjuhën angleze) në të vërtetë i mungon qartësimi, mirëpo duke e lexuar tërë dispozitivin sqarohet se një dënim unik për dy veprat penale Krime të luftës kundër civilëve sipas nenit 142 në lidhje me nenet 22, 24, 26 dhe 30 të KP të RSFJ-së i është shqiptuar të akuzuarve **Nezir Mehmeti dhe Rustem Mustafës** (pikat 5 dhe 8 të aktakuzës) dhe tri prej tyre të akuzuarit **Lutfi Gashit** (pikat 5, 8 dhe 14 të aktakuzës). Prandaj, Gjykata Supreme gjen se në lidhje me këtë nuk është bërë asnjë shkelje esenciale e nenit 364 paragrafi 11 të LPP-së nga gjykata e shkallës së parë.

Neni 357 paragrafi 5 i LPP-së shkruan si në vijim:

“Në rastin e bashkimit të veprave penale, gjykata në dispozitivin e aktgjykimit do të shënojë dënimet e përcaktuara për secilën veprë penale, e pastaj dënimin që është dhënë për të gjitha veprat në bashkim”.

Neni 48 paragrafi 1 të KP të RSFJ-së, relevant në lëndën në fjalë, përcakton si në vijim:

(1) Në qoftë se kryerësi me një veprim ose me disa veprime ka kryer disa vepra penale për të cilat ai gjykohet njëkohësisht, gjykata më parë do të caktojë dënimet për secilën nga këto vepra e pastaj për të gjitha këto vepra do të jap dënimin unik.

(2) Dënimin unik gjykata do ta jap sipas këtyre rregullave: ...

38. Dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë sa i përket dënimit shkruan si në vijim:

“[I] akuzuari **Luft Gashi** shpallet fajtor për veprën penale krime lufte kundër civilëve siç është përshkruar në pikën 5, pikën 8 dhe pikën 14 të aktakuzës së ndryshuar të 30 qershorit 2003 dhe siç përshkruhet në vijim;”

“[Të] akuzuarit **Nasir Mehmeti** dhe **Rustem Mustafa** shpallen fajtorë për veprën penale krime lufte kundër civilëve siç është përshkruar në pikën 5 dhe pikën 8 të aktakuzës së ndryshuar të 30 Qershorit 2003 dhe siç përshkruhet në vijim;

Pika 5 nga tetori 1998 deri në fund të prillit 1999, **Luft GASHI**, **Nasir MEHMETI** dhe **Rustem MUSTAFA**, në bazë të një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale, kanë urdhëruar dhe kanë marrë pjesë në themelimin dhe vazhdimin e trajtimit çnjerëzor të civilëve shqiptarë të Kosovës të paraburgosur në qendrën e paraburgimit që ndodhej në Llapashticë, duke i mbajtur këta civilë të paraburgosur në kushte çnjerëzore, duke i privuar nga kushtet adekuate higjienike, ushqimi dhe uji, dhe trajtimi i nevojshëm mjekësor. Trajtimi çnjerëzor i civilëve të paraburgosur ka shkaktuar vujtje të pamasë apo ishte shkelje e integritetit trupor dhe shëndetit të atyre personave të paraburgosur dhe përbënte zbatim të masave të frikësimit dhe terrorit. Si rrjedhim mbajnë përgjegjësi personale dhe më të lartë për krime lufte në kundërshtim të nenit 142 të KPJ-së në lidhje me nenet 22, 24, 26 dhe 30 të KPJ-së.

Pika 8 **Luft GASHI**, **Nasir MEHMETI** dhe **Rustem MUSTAFA**, nga tetori 1998 deri në fund të prillit 1999, në bazë të një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale kanë urdhëruar dhe kanë marrë pjesë në rrahjen dhe torturimin e civilëve shqiptarë të Kosovës të paraburgosur në qendrën e paraburgimit në Llapashticë në përpjekje që me dhunë t'i detyrojnë ata që të pranojnë aktet e tradhtisë ndaj UÇK-së. Si rrjedhim mbajnë përgjegjësi personale dhe më të lartë për krime lufte të trajtimit çnjerëzor, vujtjes shumë të madhe apo shkeljes së integritetit trupor apo të shëndetit, zbatimit të masave të frikësimit dhe terrorit dhe torturës sipas nenit 142 të KPJ-së në lidhje me nenet 22, 24, 26 dhe 30 të KPJ-së.

Pika 14 nga 2 Gushti 1998 deri në fund të shtatorit 1998 **Luft GASHI**, ka urdhëruar dhe ka marrë pjesë në rrahjen dhe torturimin e M S një rojtar pylli serb i cili ka qenë i paraburgosur në qendrat e paraburgimit që ndodheshin në Bare, Bajgorc në tentim që ta detyrojë të pranojë se ka kryer akte kundër UÇK-së ose që të jep informata të inteligjencës, dhe si rrjedhim mbanë përgjegjësi personale për krime lufte të trajtimit çnjerëzor, vujtjes së pamasë dhe shkeljes së integritetit trupor ose të shëndetit, zbatimit të masave të frikësimit dhe terrorit dhe torturës sipas nenit 142 të KPJ-së në lidhje me

nenet 22, 24, 26 dhe 30 të KPJ-së.[...]

Për arsytet e lartpërmendura trupi gjykues, sipas neneve 42 dhe 48 paragrafëve (1) dhe (2), nën- paragrafit (1) të LPP-së shpall këtë:

DËNIM

1. **Lutfi Gashi** do të vuaj dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 vitesh;
2. **Naim Mehmeti** do të vuaj dënimin me burg në kohëzgjatje prej 3 vitesh;
3. **Rustem Mustafa** do të vuaj dënimin me burg në kohëzgjatje prej 4 vitesh;

[...]”

39. Gjykata Supreme e Kosovës gjen se në të vërtetë dënimi si i tillë nuk i përmbush kushtet e nenit 357 paragrafit 5 të LPP-së, dhe përveç kësaj, formulimit të tij i mungon referenca e qartë në nenin 48 të LPP-së, që është e detyrueshme. Kjo e dyta do të ishte rasti nëse do të përcaktohej se secili i akuzuar do të vuaj një dënim “unik” prej ...[x]...vitesh.

Sa i përket nenit 357 paragrafit 5 të LPP-së, duhet theksuar se sipas komentareve përkatës mosrespektimi i dispozitave shpie në pa-kuptueshmëri të dispozitivit siç është paraparë me nenin 364 paragrafin 11 të LPP-së:

“nëse dënimi individual, i përcaktuar për veprat penale në bashkim, nuk është shënuar në dispozitivin e aktgjykimit, atëherë dispozitivi i aktgjykimit do të jetë i pakuptueshëm (neni 364 paragrafi 1, pika 11), siç nuk do të ishte evidente, në bazë të cilit dënim individual është shpallur dënimi” (Branko Petriq; Komentari mbi Ligjin e procedurës penale 1986; Botimi i 2-të, Gazeta Zyrtare e RSFJ-së; Beograd; Neni 357;pika IV.4.).

Megjithatë, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se kjo brengë nuk është relevante në lëndën në fjalë pasi që nuk mund të përfundohet se “nuk është evidente, në bazë të cilit dënim individual është shpallur dënimi”.

40. Në lëndën në fjalë, sqarohet nga referenca e nenit 48 paragrafëve 1 dhe 2, nën- paragrafit 1 të LPP-së të bërë nga gjykata e shkallës së parë në hyrjen e saj të dënimin, se gjykata ka pasur për qëllim të shqiptojë një dënim unik në bazë të dënimeve të ndara për secilin të akuzuar dhe pikave përkatëse në fjalë. Kjo, në lidhje me specifikimin e pikave përkatëse të aktakuzës së detajuar siç është cekur më parë, e bënë pa asnjë dyshim shumë të qartë se gjykata e shkallës së parë ka dënuar secilin prej tre të akuzuarve për disa vepra penale krime lufte kundër civilëve sipas nenit 142 në lidhje me nenet 22, 24, 26 dhe 30 të LPP-së, p.sh. **Naim Mehmeti** dhe **Rustem Mustafa** për dy pika, dhe **Lutfi Gashi** për tri.

41. Të dy gjetjet e lartpërmendura të Gjykatës Supreme bëhen edhe më të qarta duke e marrë parasysh pjesën përkatëse të arsyetimit mbi dënimin e të akuzuarve, i cili shkruan si në vijim (në faqe 31 të versionit në gjuhën angleze):

*“Duke i marrë si më të rëndat sjelljet e përshkruara në Pikën 8 (duke i pasur parasysh rrahjet dhe torturimet e përsëritura si më të rënda se paraburgimin në kushte çnjerëzore), **Rahim Mustafaj** dënohet me 4 vite burgim, **Nezir Mehmeti** me 3 vite burgim dhe **Lutfi Gashi** me 5 vite burgim. Sa i përket Pikës 5, 2 vjet i shtohen dënimit të **Rahim Mustafaj**, 1 vit e gjashtë muaj dënimit të **Nezir Mehmeti** dhe 2 vite dënimit të **Lutfi Gashi**. Përfundimisht, sa i përket Pikës 14, **Lutfi Gashi** dënohet edhe me 2 vjet tjera burgim, të cilat duhet t’i shtohen atyre të mëparshmeve të shqiptuara kundër të akuzuarit. Totali prej (6, 4.5 dhe 9 vite, respektivisht) i nënshtrohet aplikimit të rrethanës zvogëluese që aplikohet ndaj të gjithë të akuzuarve”.*

42. Gjykata Supreme e Kosovës konsideron pa asnjë dyshim se gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar dënime të ndara për secilën pikë përkatëse të aktakuzës të kryer nga secili i akuzuar dhe pastaj – në bazë të kësaj – ka shqiptuar dënimin unik për secilin prej tyre siç përcaktohet me nenin 48 paragrafët 1 dhe 2 , nënparagrafin 1 të LPP-së, dhe e ka reflektuar në dispozitiv në pjesën e dënimit.

43. Për më tepër, mbrojtja e **Rahim Mustafaj** ka theksuar se gjykata e shkallës së parë nuk ka sqaruar në mënyrë adekuate nocionin “superior”, kur i është referuar rolit udhëheqës të të akuzuarit përkatës. Prandaj, mbrojtja pretendon se **dispozitivi është kundërtënës në pjesën ku flitet për “përgjegjësinë personale dhe superiore” të të akuzuarit.**

44. Gjykata Supreme e Kosovës në lidhje me këtë gjen se gjykata e rigjyimit në shkallën e parë i është referuar plotësisht një numri të fakteve tanimë janë vërtetuar në shqyrtimin gjyqësor në vitin 2003 (P 425/01) dhe prandaj është konfirmuar me vendimin e Gjykatës Supreme Ap.-Kz. 139/2004. Kjo qasje e gjykatës së rigjyimit është bazuar vetëm në konsideratën e gjykatës për rolin e kufizuar në shqyrtimin e pikave 5, 8, 9 dhe 14 të aktakuzës origjinale të ndryshuar të datës 30 qershor 2003. Kjo e fundit në veçanti mund të kuptohet nga arsyetimi i gjerë i gjykatës sa i përket interpretimit të vendimit të Gjykatës Supreme Ap.-Kz. 139/2004 (faqe 8 ff në veçanti faqe 10 e versionit në gjuhën angleze). Lidhur me këtë, vlen të përmendet se gjykata e rigjyimit e shkallës së parë në veçanti në lidhje me pjesët e pikave 5 dhe 8 të aktakuzës së 16 korrikut 2003 i është referuar Parimeve të së Drejtës Zakonore të *tantum devolutum quantum appellatum*, të cilat janë të aplikueshme në Kosovë gjithashtu dhe do të thotë se gjyqtari i apelit mund të vendos vetëm në ato pjesë të vendimit të ankimuar, të cilat janë kontestuar nga cilado palë. Në këtë pikë, gjykata e rigjyimit e shkallës së parë e ka konsideruar pikëpamjen e mbrojtjes së të tre të akuzuarve si të saktë, se pjesët përkatëse të pikave prej të cilave të akuzuarit janë liruar, nuk ishin kundërshtuar nga Prokurori dhe për këtë arsye janë bërë *res judicata*. Duhet nënvizuar në kontekstin e dhënë se aplikimi i parimit ligjor sikur ky në fjalë nuk mund të kufizohet vetëm në pjesë të caktuara të lëndës dhe vetëm sa i përket rezultateve të caktuara të favorizuara, por duhet të bëhet në mënyrë unike duke iu referuar tërë lëndës. Duke u nisur nga kjo, parimi *narra mihi factum, narra tibi ius* na

shpie te rezultati se faktet tanimë të vërtetuara dhe të pakontestuara të lëndës krijojnë bazë për gjyqtarin përkatës për ta zbatuar ligjin e aplikueshëm. Kjo liri e gjyqtarit për ta zbatuar ligjin në përgjithësi kufizohet deri në një masë vetëm nga karakterizimi ligjor i fakteve të pretenduara në aktakuzë. Sidoqoftë, ajo që është mbledhur nga vetë Gjykata e Qarkut në Prishtinë do të mjaftonte, vetëm, për ta dënuar këtë të pandehur së paku për faktet e paraqitura në Pikën 5 të aktakuzës së ndryshuar të datës 30 qershor 2003.

45. Përfundimisht, sa i përket pozicionit të mbrojtjes se **dispozitivi nuk e ka përshkruar përmbajtjen e Pikës 9 të aktgjykimit të kundërshtuar kundër Lutfi Gashi dhe Rustem Mustafës e as nuk ka deklaruar pse është refuzuar akuza**, Gjykata Supreme e Kosovës e konsideron këtë argument fare jomeritor. Në mënyrë të qartë mund të lexohet në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë se “ *Trupi gjykues, duke vërejtur se më 30 shtator 2009, Prokurori e ka tërhequr akuzën kundër Lutfi Gashi dhe Rustem Mustafës sa i përket pikës 9 të aktakuzës së ndryshuar, pas leximit të nenit 349 n.3 të Ligjit mbi Procedurën Penale të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, REFUZON akuzën e pikës 9*” (faqet 2 dhe 3 të versionit në gjuhën angleze). Pasi ky arsyetim është vetë-sqarues, Gjykata Supreme në këtë pikë përmbahet nga çfarëdo sqarimi i më tutjeshëm. Pasi që akuza është tërhequr nga Prokurori, nuk ka pasur nevojë që përsëri të përmendet përmbajtja e tij në aktgjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës deri më tani vëren se në të vërtetë nuk ka përshkrim të përmbajtjes së pikës 9 në aktgjykimin e kundërshtuar të shkallës së parë. Sidoqoftë, Gjykata Supreme gjen se ky fakt – edhe pse nuk është në përputhje me procedurën - nuk e dëmton askënd, pasi që pika përkatëse është tërhequr nga Prokurori gjatë fjalimit të tij përfundimtar dhe prandaj është refuzuar nga gjykata e rigjykimin e shkallës së parë, e që për këtë arsye kjo pjesë e procedurës është në mënyrë të qartë në dobi vetëm të tre të akuzuarve. Në kontekstin e dhënë nuk janë konstatuar shkelje procedurale që do të shpinin në anulimin e aktgjykimit të kundërshtuar.

II. Kontradiktat lidhur me arsyetimin e aktgjykimit të shkallës së parë

46. Avokatët mbrojtës të tre të akuzuarve kanë kundërshtuar arsyetimin e aktgjykimit si të tillë.

1. Kontradiktat e pretenduara në mes të dispozitivit dhe arsyetimit lidhur me dënimin

47. Avokati mbrojtës, në veçanti i Lutfi Gashi ka pretenduar se dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me arsyetimin sepse Lutfi Gashi është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) vitesh, “për një vepër penale”, kurse në arsyetimin e aktgjykimit, një dënim specifik është shpallur kundër të pandehurve për secilën pikë të aktakuzës dhe sipas kësaj dënimi do të ishte më i lartë dhe në veçanti në rastin e Lutfi Gashi do të ishte nëntë (9) vite.

48. Gjykata Supreme sa i përket kësaj pike i referohet asaj që tanimë është theksuar më parë nën paragrafin A.I. 3, në veçanti faqe 14, pikën 36 ff, të këtij aktgjykimi. Gjykata e

shkallës së parë pa asnjë dyshim ka shqiptuar një dënim unik, i cili është përshkruar në dispozitiv dhe në bazë të dënimeve të ndara për secilën pikë përkatëse të aktakuzës siç është shtjelluar në pjesën e dënimit në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar (faqe 31 e versionit në gjuhën angleze). Prandaj, në këtë kontekst nuk është konstatuar asnjë shkelje e nenit 364 paragrafit 1, pikës 11 të LPP-së.

2. Shkelja e pretenduar e procedurës penale duke e shpërfillur emrin ligjor të veprës penale të identifikuar

49. Mbrojtja ka theksuar se gjykata e shkallës së parë ka shkelur procedurën penale pasi që ka shpërfillur emrin ligjor të veprës penale të shqiptuar, e cila sipas nenit 142 të KP-së të RSFJ-së do të ishte “Krime lufte kundër popullatës civile” dhe jo si në formulimin e gjykatës së shkallës së parë “Krime lufte” ose “Krime lufte kundër civilëve”.

50. Gjykata Supreme lidhur me këtë gjen se gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj në mënyrë të qartë i referohet veprës penale të përkufizuar me nenin 142 të KP-së të RSFJ-së në lidhje me nenet 22, 24, 26 dhe 30 të KP-së të RSFJ-së. Fakti që gjykata nuk e përsërit emrin e veprës penale në mënyrë servile nuk e ndikon marrjen e dukur dhe të ligjshme të aktgjykimit, në veçanti duke pasur parasysh se emri i veprës penale siç është përkufizuar me ligj është në diskrecion të ligjvënësit dhe i shërben qëllimit për të bërë dallim të qartë prej të tjerave, me siguri dispozitive të ngjashme, mirëpo fare nuk ka ndikim në përmbajtjen e veprës penale përkatëse. Prandaj, në këtë kontekst nuk mund të konstatohet se ka pa kuptueshmëri apo mospërputhje në aktgjykimin e kundërshtuar.

3. Domosdoshmëria për t'i specifikuar shënimet personale të secilit civil të përfshirë në veprën penale Krime lufte sipas nenit 142 të KP-së të RSFJ-së

51. Mbrojtja e të akuzuarit pretendon në shkelje të nenit 364 paragrafit 1, pikës 11 të LPP-së për shkak se aktgjykimi i kundërshtuar i shkallës së parë nuk ka specifikuar identitetin e viktimave të privuar nga liria dhe të mbajtur në kushtet e përshkruara në dispozitiv, apo kundër të cilëve janë ndërmarrë veprimet si rrahjet dhe tortura.

52. Gjykata Supreme e Kosovës gjen se në këtë kontekst nuk mund të konstatohet asnjë shkelje e procedurës penale. Kjo sqarohet përmes një interpretimi të kushteve përkatëse të nenit 142 të KP-së të RSFJS-së.

53. Neni 142 i KP-së të RSFJS-së si nen relevant në këtë kontekst përcakton si në vijim:

Kushdo duke shkelur rregullat e së drejtës ndërkombëtare gjatë kohës së luftës, konfliktit të armatosur ose të okupacionit urdhëron që kundër popullsisë civile të bëhen [... lista e veprave penale relevante ...] ose kushdo që kryen ndonjërin nga veprat e lartpërmendura, do të dënohet ...

54. Nga komentaret, mund të kuptohet se neni 142 i KP-së të RSFJ-së mbron popullatën civile në tërësi. Komentaret shkruajnë si në vijim:

“Popullsia civile është viktim e aktit kriminal. Mbrojtja ligjore-penale përfshin të gjithë civilët në territorin e zaptuar, dmth edhe qytetarët e vendit i cili është tërësisht ose pjesërisht i zaptuar e edhe të huajt. Mbrojtja po ashtu i adresohet civilëve në kompetencat e agresorit po ashtu kur ata nuk janë në territorin e vendit të tyre [...]” (Ljubisa Lazarevic; Komentim i Kodit Penal të ish RJ; 1995; Botimi i 5të; Savremena Administracija; Belgrade; Neni 142; pika 3.në fund)

55. Prandaj Gjykata Supreme konsideron se – megjithëse të dhënat personale të specifikuar të viktimave të pretenduara mund të jenë me ndihmesë në raste të caktuara – nuk është gjithmonë e domosdoshme të specifikohen identitetet e personave që mund të jenë çështje të akteve të penalizuara nën Nenin 142 të KP të RSFJ. Kjo në veçanti zbatohet kur elementet subjektive dhe objektive të veprave të njëjta penale janë përmbushur dhe shqyrtuar, të dëshmuara nga Gjykata sikurse në lëndën e tanishme.

Adresimi është bërë në atë çfarë tanimë ishte vërtetuar në vazhden e historisë procedurale sikurse është përshkruar në këtë Aktgjykim (f.4 dhe 5, pika 9). Është gjetur se Gjykata ri-gjyquese e shkallës së parë kishte dëgjuar dëshmitarët K H G Z , S C R E , K P , N G N I , K K , M L I S , A M , T A , V J , F M , F S M S dhe R B dhe se të gjithë dëshmitarët kanë konfirmuar deklaratat e tyre të dhëna Gjyqtarit Hetues në vitin 2002 ose para trupit gjykues të Shkallës së parë në vitin 2003 si edhe janë përgjigjur në kërkesën mbi disa pyetje shtesë. Po ashtu është konstatuar se Gjykata ri-gjyquese e shkallës së parë në materialin gjyqësor ka futur si dëshmi edhe deklaratat e dëshmitarit anonim “Q” të dhënë Gjyqtarit Hetues më 01 dhe 11 Shkurt 2002, deklaratën e dëshmitarit S B , të dhënë Gjyqtarit Hetues më 18 Korrik 2002, deklaratat e dëshmitarit anonim 4” të dhënë Gjyqtarit Hetues më 18 Tetor 2002 dhe shënimet e dëshmisë së dëshmitarit të dhënë në shqyrtimin gjyqësor më 20 dhe 21 Mars 2003 si edhe deklaratën e dëshmitarit V V (dëshmitari në origjinal “H”) të dhënë Gjyqtarit Hetues më 06 Shkurt 2002 dhe shënimet e dëshmisë së dëshmitarit të dhënë në shqyrtimin kryesor më 05 Mars 2003. Shumë nga dëshmitarët kanë qenë në anën e viktimave gjatë asaj kohe, kur krimet në fjalë janë kryer.

56. Përkundër ligjit të parë vendor të aplikueshëm në rastin në fjalë, njëri nga parimet kyqe të ligjit humanitar ndërkombëtar është që jo-luftuesit (civilët por po ashtu ish luftuesit, sikurse janë të burgosurit e luftës dhe luftëtarët *hors de combat* sepse ata janë plagosur, sëmurë, përmbytur ose janë dorëzuar, e të cilët të gjithë shpesh janë adresuar si “persona të mbrojtur”) duhet të kursehen nga format e ndryshme të lëndimeve, pavarësisht nga identitetet e tyre. Prandaj në zemër të krimeve të luftës është siguruar ligji i një sërë ndaljeve të dhunës kundër dhe keqtrajtimit të jo – luftuesve.

57. Tribunali Penal Ndërkombëtar për Ish Jygosllavinë (TPNJ) , në vërtetimin e konditave ligjore të Krimeve të Luftës ka përcaktuar se “viktimat e krimeve të supozuara duhet të cilësohen si persona të mbrojtur në pajtim me dispozitat e vitit 1949 të Konventës së Gjenevës” (TPNJ Dhoma e Gjykimit I, Prokurori v Brdjanin, Aktgjykim i datës 1 Shtator 2001, paragrafi 121; dhe po ashtu TPNJ Dhoma e Gjykimit II, Prokurori v Simic, Tadic dhe Zaric, Aktgjykimi, Dhoma e Gjykimit data 17 Tetor 2003, paragrafi 106) , dhe/ose atë “ pasi që Neni i Përbashkët 3 mbron personat që nuk marrin pjesë në mënyrë aktive në veprimet ushtarake, viktimat e dhunës së supozuar që nuk është dashur të marrin pjesë në mënyrë aktive në veprimet ushtarake në kohën kur është kryer krimi” (TPNJ Dhoma e Gjykimit II, Prokurori v. Fatmir Limaj et al, Aktgjykim i datës 30 Nëntor 2005 paragrafi 176).

58. Specifikimi i identitetit të viktimave sikurse janë emrat, mbiemrat, data dhe vendi i lindjes etj nuk janë kërkuar asnjëherë deri më tani. Kjo, veç kësaj do të qonte në një situatë mjaftë të diskutueshme që për hir të përgjigjjes së penale të kryerësve të supozuar, do të duhej të bëhej publik identiteti i dëshmitarëve anonim në vendimet e gjykatës. Duke konsideruar faktin se në rastet e krimeve të luftës – e jo vetëm në lëndën në fjalë – mund të ketë ish viktima të shumta të cilët janë të vullnetshëm të deklarojnë vetëm në mënyrë anonime, rezultati do të ishte mungesa e dëshmitarëve të cilët dëshirojnë të dëshmojnë fare.

4. Zbatimi jo i plotë dhe i gabuar i supozuar dhe citimi i Neni 22 of LPP në dispozitivë

59. Mbrojtja, posaçërisht e **L. G. G.**, ka atakuar dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë për shkak të faktit se në Pikën e tij 14 përshkruhen vetëm veprimet e ndërmara nga **L. G. G.**, përderisa në cilësimin e veprave penale për të cilat ata janë shpallur fajtor janë zbatuar dispozitat e Neni 22 të KP të RSFJ, që ndëshkon bashkë-kryerjen.

60. Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se nuk mund të vërtetohet shkelje esenciale e procedurës penale në këtë aspekt. Kjo qartë shquhet nga leximi dhe interpretimi i Neni 22 të KP RSFJ.

61. Neni 22 i RSFJ përcakton me sa vijon:

Nëse disa persona kryejn bashkë një akt kriminal duke marrë pjesë në aktin e kryerjes ose në një mënyrë tjetër, secili nga ata duhet të ndëshkohet sikurse përshkruhet për aktin.

62. Gjykata Supreme kupton qëllimin e Mbrojtjes për tu ankuar për fatkin se nuk do të ishte e mundur që një krim të kryhet në bashkë-kryerje pa identifikimin e bashkë-kryerësve të tjerë (ose e të gjithë të tjerëve).

63. Po ecën pa thënë se bashkë-kryerja kërkon një grup të njerëzve (së paku dy), të cilët bashkpunojnë me njëri tjetrin vullnetshëm me qëllim të kryerjes së një krimi. Kjo po ashtu mbështetet me definimin e dhënë në komentimet relevante, duke definuar që bashkëpunimi në KP RSFJ është “një veprim i vetëdijshëm dhe i vullnetshëm i shoqërimit

me pjesëmarrës të tjerë, me qëllim të kryerjes së përbashkët të një veprimi të caktuar” (Ljubisa Lazarevic, Komentimi i Kodit Penal të ishRJ 1995, Botiti i 5të; Savremena Administracija; Beogradë; Neni 22; pika (1).

Meqë, pa asnjë diskutim përgjegjësia penale gjithmonë medoemos është personale, dhe prandaj të gjitha teoritë formale-objektive si edhe subjektive mbi bashkëpunimin pra të pasurit ndikim në kualitetin e pjesëmarrjes në një krim si kryerës kyq ose vetëm si ndihmës, kërkon gjithashtu një person të definuar qartë si bashkëfajtor, nuk është e nevojshme për autoritetet e hetuesis ose për gjykatësin të dijn të gjithë kryerësit e një krimi me të dhëna personale, e nëse kjo mund të vërtetohet, në çfarë mënyrë është kryer krimi dhe nëse së paku mund të definohet njëri nga grupi i kryerësve të supozuar duke përfshirë përzierjen e tij ose saj në krim. Po ecën pa thënë se mungesa e informatave për bashkë-kryerësit e tjerë nuk mund të qoj në rezultatin se një person nën dyshimin e arsyeshëm të kryerjës së një krimi nuk do të ndiqet penalisht dhe/ose dënohet sipas ligjit. Gjykata Supreme i adresohet dënimit të saj të mëparshëm sikurse është vërtetuar në rastin e Bedri Krasniqi (Gjykata Supreme e Kosovës, Aktgjykimi në lëndën e ~~Bedri Krasniqi~~, Ap.-Kz. 153/08, 12 Janar 2010, f.21-22 versioni në Gjuhën Angleze). Aktgjykimi në fjalë përcakton me sa vijon:

“Meqë nuk ka më tepër sesa ky definim shumë i dobët ligjor, literatura defino bashkëpunimin në KP RSFJ si “një veprim i vetëdijshëm dhe i vullnetshëm i shoqërimin me pjesëmarrës të tjerë, me qëllim të kryerjes së përbashkët të një veprimi të caktuar” (Ljubisa Lazarevic, Komentimi i Kodit Penal të ish RJ 1995, Botiti i 5të; ” Savremena Administracija” Beogradë; f. 66, pika (1) e Nenit 22 e RSFJ).

Pa diskutim, ky definim kërkon një grup të njerëzve, të cilët bashkëpunojn vullnetshëm me njëri tjetrin me qëllim të kryerjës së një krimi. Natyrisht, pasi që përgjegjësia penale gjithmonë medoemos është personale, të gjitha teoritë formale-objektive si edhe subjektive mbi bashkëpunimin, pra të pasurit ndikim në kualitetin e pjesëmarrjes në një krim si kryerës kyq ose vetëm si ndihmës, kërkon gjithashtu një person të përcaktuar qartë si bashkëfajtor. Parimi i individualizmit përfshin individin pjesëmarrës si edhe vet aktin e njejtë. Çfardo kuptimi tjetër lehtaz mund të qoj në një situatë të mos-përgjegjësia penale.

Megjithatë, madje edhe duke konsideruar komponentin objektiv si edhe atë subjektiv të bashkëpunimit si një akt, të bazuarit në dëshirën e personit i cili vepron (që ky i fundit po ashtu kërkon një person prapa veprimit), në anën tjetër nuk është e nevojshme për autoritetet e hetuesisë ose gjyqtarin të njoh të gjithë kryerësit e krimin me të dhëna personale, nëse kjo mund të vërtetohet, në çfarë mënyrë është kryer krimi dhe nëse mund të definohet, së paku, njëri nga grupi i kryerësve të supozuar duke përfshirë përzierjen e tij ose saj në krim. Mos të mbetet pa u thënë se mungesa e informatave për bashkë-kryerësit e tjerë nuk mund të qoj në rezultatin se një person nën dyshimin e arsyeshëm të kryerjës së një krimi nuk do të ndiqet penalisht dhe/ose dënohet sipas ligjit. [...].

E njëjta do të aplikohet për aktin kriminal të dhënies ndihmë diku tjetër, sipas Nenit 24 të KP KSAK, pasi që të ndihmuarit njihet si një form tjetër e bashkëpunimit (Ljubisha Lazarevic, Komentimi i Kodit Penal të ish RJ, botimi i 5të, , "Savremena Administracija" Beograd, f. 76, pika (1) në Nenin 24 KP RSFJ). Megjithëse çështja e asistimit po ashtu është adresuar nga Avokati Mbrojtës në ankesë, nuk është e nevojshme të shkohet me thellë në detaje, pasi që i pandehuri nuk ishte as i akuzuar as i dënuar për ndihmë dhe Aktgjykimi i shkallës së parë nuk është atakuar deri në atë nivel".

64. Prandaj fakti që emrat e bashkë-kryerësve nuk janë përmendur në dispozitivë nuk e bën Aktgjykimin e shkallës së parë të paligjshëm.

5. Keqinterpretimet e supozuara të Aktvendimit të Gjykatës Supreme Ap.-Kz. 139/2004 nga Gjykata e shkallës së parë

65. Më tej mbrojtja e ~~L. Gashi~~ dhe e ~~N. Mehmeti~~ ka pohuar për shkelje të dispozitave të procedurës penale sepse, gjoja, Gjykata e shkallës së parë ka keqinterpretuar Aktvendimin e Gjykatës Supreme Ap.-Kz. 139/2004 që "PRISHI DHE ANULOJ TËRËSISHT" aktvendimin P 425/2001 dhe dërgoi lëndën mbrapa për rigjykim.

66. Gjykata Supreme e Kosovës, pas analizës së kujdesshme të aktvendimit të adresuar Ap.-Kz. 139/2004 të Gjykatës Supreme konstaton se nuk mund të vërtetohen keqinterpretime të rënda të bëra nga Gjykata e Qarkut, në veçanti në kuadër të akuzave të adresuara të Krimeve të Luftës kundër Popullsisë Civile.

67. Gjykata Supreme, në vendimin e saj Ap.-Kz. 139/2004, ka vërtetuar se një numër i akuzave duhet të konsiderohen "jo të bazuara në ligj", në veçanti ato të paraqitura në Pikat 1, 2, 3 dhe 12 të aktakuzës së ndryshuar të 30 Qershorit 2003 dhe të dëshmuara me Aktgjykimin P 425/2001 të shqyrtimit gjyqësor. Gjykata Supreme në arsyetimin e saj, ka vënë në pah se "as Neni 3 i Përbashkët për Konventat e Gjenevës as Neni 6 i Protokollit II të saj të ndërlidhur nuk i adresohet arrestimit të paligjshëm ose paraburgimit të paligjshëm gjatë periudhës së një konflikti të brendshëm të armatosur" (faqe 12, versioni në Gjuhën Angleze i Ap.-Kz. 139/2004). Prandaj, akuzat përkatëse (për të përdorur formulimin e Aktvendimit Ap.-Kz. 139/2004 të Gjykatës Supreme) duhet të "ANULOHEN NË TËRËSI".

68. Bazuar në këtë, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, në Aktgjykimin e saj të atakuar (P 526/05) ka konkluduar se disa çështje të lëndës, në veçanti Pikat 1, 2, 3 dhe 12 të aktakuzës, duhet të konsiderohen *res judicata*, përderisa të tjerat ishte dashur të shqyrtohen në ri-gjykim. (P 526/05, f.11 e versionit në Gjuhën Angleze). Prandaj, Gjykata rigjyquese e shkallës së parë është e kufizuar për ri-gjykim vetëm në Pikat 5, 8, 9 dhe 14 të aktgjykimin të atakuar.

69. Gjykata Supreme e Kosovës tani vërteton këtë interpretim të Gjykatës ri-gjykuese të shkallës së parë të jetë në vijë me ligjin e aplikueshëm. Ajo gjen arsytim po ashtu në komentet të cilat përcaktojnë se “[nëse] aktgjykimi vetëm pjesërisht është anuluar, pjesa e aktgjykimit e cila është efektive nuk mund as të diskutohet as të ndryshohet në procedurat e reja (Gjykata Supreme e Jugosllavisë, Kz. 29/71 e 26të Januar 1972), por ajo pjesë më tepër, nëse dënohet, duhet të merret parasysh dhe duhet të aplikohet Neni 48 i KP RSFJ, edhe po që se aktgjykimi i ri gjithashtu është dënues” (Branco Petric; Koment për Ligjin e Procedurës Penale 1986; Botimi i 2të, Gazeta Zyrtare e RSFJ; Beograd; Neni 390; pika 1.3.) ose që “pjesët e padiskutueshme të aktgjykimit sigurojnë efektshmëri ligjore substantive, njësoj sikurse pjesët të cilat janë kontestuese me një ankesë, por për të cilat aktgjykimi nuk është prishur. Këto pjesë nuk janë temë shqyrtimit e një gjykimi në shqyrtimin gjyqësor të ri, e as e një ankesë kundër një vendimi të ri [...]” (Momcilo Grubac&Tihomir Vasiljevic, Koment për Ligjin e Procedurës Penale 1982; Botimi i 2të; Savremena Administracija; Beograd; Neni 385; pika (22)).

Përkundër çështjes nëse Gjykata rigjykuese e shkallës së parë i ka marrë si duhet dhe tërësisht si edhe i ka vlerësuar dëshmitë në secilën pikë (një çështje për të cilën do të diskutohet në një fazë më të vonshme të Aktgjykimit (shih B.II., f.36-44)), Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se Gjykata e Qarkut në Prishtinë ka kuptuar siç duhet kufizimin e saj formal në pikat përkatëse sikurse edhe ka pasur qëllim Gjykata Supreme në vendimin e saj Ap.-Kz. 139/2004.

Adresimi i Gjykatës ri-gjykuese të shkallës së parë në Pikën 11:

70. E njëjta Mbrojtje veç kësaj ka atakuar, që është po ashtu relevante në kontekstin e dhënë, **se arsyetimi i Aktgjykimit në vetvete do të ishte kontradiktor**, pasi që Gjykata e shkallës së parë, ka ndërlidhur pozicionin e saj në lidhje me pikën 8 jo vetëm me vendimin e Gjykatës Supreme por, poashtu me **pikën 11 të aktakuzës**, që ka të bëjë me pesë vrasje nga të cilat i akuzuari është liruar.

71. Deri në këtë nivel, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se Gjykata e shkallës së parë vetëm ka cituar Gjykatën Supreme me aktvendimin e saj Ap.-Kz.139/2004 duke thënë ky i fundit ka konstatuar se kolegji i parë nuk kishte në dispozicion dëshmi direkte por vetëm të varura nga rrethanat për disa aspekte esenciale të pikës përkatëse. Prandaj, Gjykata e Qarkut në Prishtinë në Aktgjykimin e saj P 526/05 ka konsideruar se pjesa relevante e vendimit duhet të merret e formës së prerë sepse “Aktgjykimi në shkallën e dytë që vërteton se nuk mund të arrihet asnjë faj përtej dyshimit të bazuar i përgjigjet në lëndë lirimit të formës së prerë” dhe se një rezultat tjetër do të qonte në shkelje të moslejimit të rrezikut të dyfishtë ose të parimit *ne bis in idem* (f.14 verisoni në Gjuhën Angleze).

72. Në lëndën në fjalë shtrohet pyetja nëse është e nevojshme që Neni 142 i KP RSFJ të lexohet si një “vepër penale e zgjeruar”, e pavarur nga numri i veprave të ndara të kryera në kontestin përkatës dhe nëse – si pasojë – në këtë lëndë Gjykata rigjykuese e shkallës së

parë është parandaluar nga interpretimi vetëm i një numri të kufizuar të pikave të cilat “janë anuluar tërësisht” nga Gjykata Supreme.

73. Tanimë është vërtetuar nën pikën A.I.3., f.14 pika 36 ff. të këtij Aktgjykimi se Kolegji rigjykses i shkallës së parë nuk i ka shqyrtuar veprat e ndryshme penale të kryera nga të akuzuarit përkatës vetëm si një vepër penale të vetme të Krimeve të Luftës kundër Popullsisë Civile në pajtim me Nenin 142 të KP RSFJ por ka shqiptur ndëshkime për secilën vepër e pastaj ka themeluar një dënim unik. Në kontestin në fjalë, çështja është nëse është e detyrueshme për gjykatat të trajtojnë disa vepra, sikurse përshkruhet në Nenin 142 të KP RSFJ, vetëm si një vepër penale e Krimeve të Luftës kundër Popullsisë Civile.

74. Nuk mund të gjendet shumë në komentetet e ligjit të aplikueshëm Jugosllavë por vetëm një fragment i cili thotë se “veprimtaritë e inkriminuara janë vendosur në mënyrë alternative në ligj, kështu që akti mund të përmbushet nga secila veprimtari. Megjithatë nëse një person kryen disa veprimtari të ngjashme ose disa veprimtari të ndryshme të implikuara në këtë Nen, kjo do të jetë një vepër penale e vetme e krimit të luftës kundër popullsisë civile, pasi që në këtë lëndë, ajo rezulton nga pikërisht një përshkrim ligjor i veprës penale se kjo është një vepër penale unike, pa marrë parasysh numrin e veprimtarive individuale të kryera. Sipas aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Serbisë Kz-2539/56, është vetëm një akt penal i krimit të luftës kundër popullsisë civile, pavarësisht se kryerësi kryen veprat veçanta në vende të ndryshme, kundër personave të ndryshëm, në periudha më të gjata kohore dhe në mënyrë të ndryshme.” (Ljubisa Lazarevic; Komentim i Kodit Penale të ish RJ; 1995; Botimi i 5të; “Savremena Administracija”; Beograd; Neni 142; pika 3 paragrafi 5).

75. Megjithëse – është i rëndësishëm – komenti nuk i adresohet formulimit përkatës, Gjykata Supreme kupton se ai interpreton veprën penale të Krimeve të Luftës kundër Popullsisë Civile sikurse përcaktohet në Nenin 142 të KP RSFJ në kuadër të një “vepre penale të zgjeruar”. Së paku, ky ishte leximi i bërë nga gjykatësi i parë dhe nga Gjykata Supreme në vendimin e saj Ap.-Kz. 139/2004.

76. Gjykata Supreme e Kosovës nuk e ndjek këtë argumentim në lëndën në fjalë. Adresimi i është bërë komenteve mbi Nenin 48 të LPP, sa i përket “veprave penale të zgjeruar”. Komenti përkatës vë në pah që “forma e tretë e mundshme e bashkëveprimit aktual të dukshëm është një vepër penal e zgjeruar. Po ashtu është edhe më e rëndësishmja, edhe nga këndvështrimi teorik edhe nga ai praktik. Nga pikëpamja praktike, sepse shfaqet shpesh dhe në një numër më të madh të veprave penale, dhe nga pikëpamja teorike sepse një definim i vetëm dhe i mjaftueshëm i kësaj forme të bashkëveprimit aktual të dukshëm nuk është bërë ende. Praktika gjyqësore nuk ka qenë e qëndrueshme në këtë aspekt po ashtu, por një pikëpamje ishte aplikuar më së shpeshti dhe ishte ajo e marrë nga Gjykata Supreme e Jugosllavisë në 1965. Sipas asaj pikëpamje, me qëllim të ekzistimit të një vepre penale të zgjeruar, kushtet e mëposhtme duhet të plotësohen: a) që i njëjti person të ketë kryer dy ose më shumë vepra të ndara të njëhershme, nga të cilat secili veprim individual përmban të gjitha tiparet ligjore të veprës së njëjtë penal dmth formën e saj të privilegjuar ose të kualifikuar; b) të ekzistoj vazhdimësi e caktuar në kohë në mes të veprave penale të kryera individualisht; c) që të gjitha veprat të implikuara nga pikëpamja e kupimit të përgjithshëm, jetës së vërtetë dhe

arsyetimit logjik të parqesin një veprimtari të tillë të vazhduar që qartë formon një tërësi të vetme; d) që aplikimi i formës së veprës penale të zgjeruar në lëndën konkrete nuk është në kundërshtim me kushtet e rregullores penale e paraqitur në normat ligjore-penale pozitive. Sipas një mendimi, kushti për ekzistimin e një vepre penale të zgjeruar është që të jetë vetëm një palë e dëmtuar ose që veprat penale të jenë kryer kundër personit të njejtë fizik apo juridik. Sipas disa autorëve të tjerë, një paramendim i vetëm është i domosdoshëm ose ekzistenca e të pasurit në dijeni të kryerësit se ai do të kryej më shumë vepra të njëjta penale ose vepra penale të të njejtit lloj [...]” (Ljubisa Lazarevic; Komentimi i Kodit Penal të ish RJ; 1995; Botimi i 5të; “Savremena Administracija”; Beograd; Neni 48; pika 1 c)).

Fillimisht Gjykata Supreme konstaton se kushtet e përshkuara për një “vepër penale të zgjeruar” si një nga rastet e bashkëveprimit aktual nuk ekziston në rastet e Krimeve të Luftës kundër Popullsisë Civile sepse veprat e vetme penale që mund të përbëjnë një krim luftime nuk mund të konsiderohen si krijim i një bashkëveprimit aktual të dukshëm në mes tyre në lëndën e tanishme. Në përgjithësi dhe duke konsideruar lartësinë e paligjshmërisë dhe energjinë penale të lejuar në kontekst penal të shumëfishtë, trajtimi ligjor i një numri të ngjashëm por të ndarë të veprave penale si një veprim penal unik mendohet i dyshimtë, nëse jo, kjo do të ishte e pashmangshme me qëllim të vlerësimit siq duhet të lartësisë së paligjshmërisë dhe fajit të kuptuar nga kryerësi përkatës. Ky nuk është rast këtu. Secili veprim i paraparë me Nenin 142 KP RSFJ ka një vlerë autonome dhe rëndësi të barabartë në përcaktimin se çfarë mund të plotësojë kushtet e një Krimeve të Luftës kundër Popullsisë Civile. E fundit sqarohet po ashtu nga komentet, duke përcaktuar se “veprimtaritë e implikuara janë vendosur në mënyrë alternative në ligj, kështu që akti mund të përmbushet nga secila veprimtari” (Ljubisa Lazarevic; Komentimi i Kodit Penal të ish RJ; 1995; Botimi i 5të; “Savremena Administracija”; Beograd; Neni 142; pika 3 paragrafi 5, f.161).

Për më tepër, trajtimi i një numri të akteve të Krimeve të Luftës kundër Popullsisë Civile vetëm si një “akt penal i zgjeruar” në pajtim me Nenin 142 të KP RSFJ do të privilegjonte kryerësit dhe kështu do të jipte signal të gabuar në atë mënyrë që sa më tepër akte të tilla të jenë kryer, aq më mirë do të jetë për kryerësit, kur janë në gjykim. Kjo e fundit nuk mund të jetë qëllimi i Ligjit, i cili ka tendencë të mbroj popullsinë civile në mënyrën më efikase. Përveç kësaj, trajtimi i krimeve të luftës si “vepra penale të zgjeruara” do të rezultonte në parandalimin e ndjekjes penale nga mbajtja përgjegjës e kryerësve të supozuar për krime të ngjashme, gjë e cila do të arrinte në nivelin e krimeve të luftës, kur këto krime janë zbuluar së voni pasi që kryerësit përkatës tanimë janë shpallur fajtor më herët për krime të luftës (*ne bis in idem*).

77. Kjo korrespondon po ashtu me dënimin e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish Jugosllavinë (TPNJ), ku në një numër të rasteve mbrojtja është përpjekur të ketë veprime të ndryshme të përmbledhura në krime luftime, të konsideruar vetëm si një “vepër penale e zgjeruar”. Megjithatë TPNJ asnjëherë nuk e ka adresuar çështjen e një “vepre penale të zgjeruar”, ajo i është adresuar faktit se kjo do të ishte relevante në dënim. (shih “rastin Celebici”; Dhoma e Gjykitimit II TPNJ, *Aktvendim për propozimin nga i akuzuari Esad Landžo bazuar në mangësit në formën e aktakuzës, dhe Aktvendimin për propozimin nga i*

akuzuari Hazim Delic bazuar në mangësit në formën e Aktakuzës Lënda IT-96-21-T (Prokurori v. Zejnil Delaciç, Zdravko Muciç po ashtu i njohur si “Pavo”, Hazim Deliç, Esad Landžo po ashtu i njohur si “Zenga”, 15 Nëntor 1996). Atje Dhoma në veçanti ka përcaktuar se çështja e akuzave kumulative ishte “relevante vetëm për shqyrtimet e dënimit, nëse të akuzuarit ishin shpallur përfundimisht fajtor për akuzat në fjalë” dhe se ekzistenca e mundshme e lidhjes në mes të krimeve të ndryshme “është çështje e cila mund të adresohet në kohën e dënimit”.

78. Për më tepër, Dhoma e Gjykimit e TPNJ në Aktgjykimin e Dënimit në “lëndën Celebici” (P.I.S./628e) e datës 09 Tetor 2001 ka konsideruar se “lënda aktuale më së miri është zgjidhur me mënyrën e dënimit global dhe të vetëm në rastin e secilit të akuzuar, në këtë mënyrë reflekton, në secilin rast, kriminalitetin total dhe fajësin e të akuzuarve” dhe prandaj ka shqiptuar vetëm një dënim të vetëm, pra dënim unik për secilin të akuzuar. Megjithatë, duke lexuar arsyet e Aktgjykimit përkatës sqarohet se Dhoma e Gjykimit ka konsideruar dhe peshuar secilën pikë të vetme e ndërlidhur me të akuzuarit. Dhoma e Gjykimit në veçanti vë në pah se do të ishte “e drejtë të merrej parasysh se çfarë rregullimi, nëse ka ndonjë, duhet të bëhet në dënimin e shqiptuar për te si rezultat i anulimit të dënimit të tij në pikat 1 dhe 2. Pikat që ndërlidhen me vrasje të vullnetshme të burgosurit si rezultat i rrahjes. Nga ana tjetër, i akuzuari mbetet i dënuar për një vepër të përfshin vrasje të vullnetshme (duke rrahur), vepër që vullnetshëm shkakton vuajtje të mëdha (përsëri duke rrahur), dy vepra të torturës duke dhunuar dhe një vepër të trajtimit çnjerëzor të burgosurve duke përfshirë përdorimin e paisjes elektrik mbi të burgosurit”.

79. Dhoma e Ankesave në Aktgjykimin e saj (JP/P.I.S./743e) të datës 08 Prill 2003 konfirmoi dënimet të shqiptuara nga Dhoma e Gjykimit më 09 Tetor 2001 dhe mbështeti dënimet e të tre akuzuarve nën Nenin 2 të Statutit të TPNJ por ka gjykuar atë ku, sikurse në shkallën e parë, dëshmit vërtetojn fajësin e të akuzuarve bazuar në kryerjet e njëjta nën Nenet 2 dhe 3 të Statutit të TPNJ, dënimi duhet të futet vetëm nën Nenin 2 të Statutit të TPNJ dhe akuzat nën Nenin 3 të Statutit të TPNJ duhet të hedhen.

80. Po ashtu, në lëndën “Prokurori vs. Drgan Nikolic” (IT-94-2-S) e datës 18 Dhjetor 2003 Dhoma e Gjykimit II e TPNJ vërtetoi në Aktgjykimin e saj të Dënimit se - megjithëse i akuzuari ishte akuzuar për pika të shumta që përmbanin akte të ndryshme penale – vetëm “një dënim i vetëm nën pikën 1 të Aktakuzës, respektivisht ndjekjet penale si krim kundër njerëzimit” ishte futur, por ekskluzivisht sepse “pika 2 (vrasja si krim kundër njerëzimit, pika 3 (dhunimi si krim kundër njerëzimit) dhe pika 4 (tortura si krim kundër njerëzimit)” tanimë ishin inkorporuar.

81. Dhe në lëndën “Prokurori vs Ranko Cesic” (CT/P.I.S./831e) e datës 11 Mars 2004 the Dhoma e Gjykimit II e TPNJ dënoi të akuzuarit me dënim unik prej 18 vitesh burgim por e ka shpallur fajtor për vrasjen e 10 individëve që përfshinte një numër të keqtrajtimeve sikurse janë rrahjet dhe trajtime të tjera poshtëruese dhe degraduese, përkundër aketeve tjera penale, të cilat nuk kanë quar në vdekjen e viktimave.

82. Gjykata Supreme e Kosovës e kupton Aktgjykimin e Gjykatës rigjykuese në këtë veçanti.

Efekti detyrues i opinioneve ligjor të Gjykatës Supreme

83. Një pyetje shtesë në vazhdim që duhet të diskutohet nëse Gjykata rigjykuese e shkallës së parë ishte e detyruar të veproj sipas pikëpamjeve ligjore të Gjykatës Supreme si deklarohet në aktvendimin Ap.-Kz. 139/2004. Megjithatë, Neni 390 paragrafi 3 i LPP qartë vë në pah se në rastin e rigjykimit “ *gjykata e shkallës së parë duhet të kryej të gjitha aktet procedurale dhe shqyrtoj të gjitha çështjet diskutabile të adresuara me aktvendimin e gjykatës së shkallës së dytë*”. Megjithëse kjo do të thotë se faktet e vërtetuara në aktgjykimin e anuluar nuk mund të merren si të vërtetuara, pavarësisht se sa të qarta dhe të pakontestueshme janë, është po ashtu e padikutueshme që “ *[nëse] gjykata e shkallës së dytë në vendimin e saj, në plotësim të udhëzimeve të caktuara, po ashtu paraqet një kuptim ligjor të caktuar, ai kuptim nuk është i detyrueshëm për gjykatën e shkallës së parë, sepse gjykata e shkallës së parë është e lirë po ashtu në vlerësim ligjor të fakteve që i vërteton në procedura, dhe nuk është e detyruar në atë aspekt nga, ose opinionet ligjore ose kuptimet ligjore dmth opinionet parimore të gjykatave më të larta [...]*” Branko Petric; *Koment mbi Ligjin e Procedurës Penale; 186; Botimi i 2të; Gazeta Zyrtare e RSFJ; Beograd; Neni 390; pika III.1 dhe 5) dhe ngjashëm (Momcilo Grubac & Tihomir Vasiljevic; Koment mbi Ligjin e Procedurës Penale; 1982; Botimi i 2të; “Savremena Administracija”; Beograd; Neni 390, pika 13).*

84. Gjykata Supreme konstaton se ky veprim procedural po ashtu është në linjë me standardet ndërkombëtare për gjykim të drejtë që kanë për qëllim shmangien e vonesave (në të interesuarit e po ashtu pala e dëmtuar) në rigjykim dhe fokusohet po ashtu në atë çfarë më herët është konstatuar përtej çdo dyshimi të bazuar.

III. Mungesa e Udhëzimit për të Drejtën në Ankesë

85. Mbrojtja e R. [redacted] M. [redacted] për më tepër ka theksuar se Aktgjykimi i shkallës së parë ishte dorëzuar pa paralajmërim mbi mjetet juridike, kështu që të akuzuarit nuk kanë qenë të njoftur për të drejtat e tyre për të atakuar Aktgjykimin.

86. Gjykata Supreme konstaton se në të vërtetë Aktgjykimi i shkruar u shkallës së parë si i tillë nuk përmban paralajmërim për mjetet juridike dhe se e drejta për të paraqitur një ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së parë është një kategori konstitucionale, e paraparë me Nenin 359 të LPP dhe dispozitat në vazhdim të pjesës përkatëse të Ligjit. Megjithatë, nuk është vetëm e vetë-kuptueshme që personat e autorizuar duhet të paralajmërohen për të drejtat e tyre në ankesë, pasi që procedurat e ankesës kundër një aktgjykimi asnjëherë nuk bëhen *ex officio* por duhet të theksohen nga apeluesi brenda afatit ligjor të dhënë. Po ashtu Neni 354 paragrafi 1 i LPP parashikon që “*pas shqiptimit të aktgjykimit, kryetari i kolegjit duhet t'i udhëzoj palët në lidhje me të drejtën e ankesës dhe të drejtën për t'u përgjigjur në ankesë*”. E fundit ishte në pajtim me këtë në bazë të

procesverbalit të seancës së fundit të datës 02 Tetor 2009 (f. 2 versioni në gjuhën angleze).

Vetëm, përderisa Neni 356 paragrafi 4 i KPP parasheh që “udhëzimi për të drejtën në ankesë duhet t’i dërgohet të pandehurit po ashtu, paditësit privat dhe palës së dëmtuar si paditës”, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se kjo nuk është në pajtim me të por së paku nuk mund të gjenden dëshmi në këto shkresa të lëndës që paralajmërimi për mjetet ligjore me shkrim ishte dërguar, nëse jo si pjesë e Aktgjykimit, atëherë si letër e njoftimit. Megjithatë, të pandehurit ishin në gjendje të përdornin mjetet e tyre ligjore përkatëse.

87. Kjo deri në një masë mund të kuptohet nga komentet në vijim:

“Nëse i akuzuari, pasi që është udhëzuar gabimisht në aktgjykim për afatin e ankesës, paraqet një ankesë kundër aktgjykimit të lëshuar në shkallën e parë pas skadimit të afatit ligjor, atëherë ankesa duhet të merret në konsideratë nga gjykata e shkallës së parë po ashtu sikurse kërkesa për lejim të rivendosjës në gjendjen e mëhershme për shkak të mangësisë të afatit ligjor për të paraqitur ankesë (Gjykata Supreme Jugosllavisë, Kz 125/54 të 03 Dhjetorit 1954; Kz 100/56 të 01 Gusht 1956)”, (Branco Petric; Komenti për Ligjin e Procedurës Penale 1986; Botimi i 2të, Gazeta Zyrtare të RSFJ; Beograd; Neni 359; pika II.3.).

88. Përmes kësaj sqarohet se dështimi i gjykatës për të dhënë paralajmërim të duhur me shkrim nuk e dëmton apeluesin, edhe nëse ankesa është e vonuar.

89. Në lëndën në fjalë, Avokatët Mbrojtës në emër të klientëve të tyre përkatës kanë bërë ankesë në kohë, gjoja pa pranuar paralajmërim për mjetet ligjore. Prandaj, ky dështim nuk e dëmton aspak Aktgjykimin.

B. Vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike

90. Avokatët Mbrojtës të tre akuzuarve kanë atakuar se Gjykata rigjyquese e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar drejt dhe tërësisht gjendjen faktike dhe se këto dështime kanë qenë në dëm të akuzuarit.

I. Dështimi i supozuar i Gjykatës së shkallës së parë për të krahasuar Kushtet Jetësore të Popullsisë Civile dhe të Burgosurve

91. Të tre Avokatët Mbrojtës kanë atakuar se Gjykata rigjyquese e shkallës së parë nuk i ka krahasuar mjaftueshëm kushtet jetësore të popullsisë civile në kohën e diskutueshme me ato të burgosurve.

92. Gjykata Supreme e Kosovës deri në një masë konstaton se kjo thënie është jo esenciale.

93. Dispozitat relevante të Ligjit Humnaitar Ndërkombëtar mund të gjenden në Protokollin II Shtesë të Konventave të Gjenevës të 12 Gushtit 1949, të datës 08 Qershor 1977, që përcaktojnë me sa vijon:

*“Pjesa II. Trajtimi Njerëzor
Neni 4 Garancionet Themelore*

1. Të gjithë personat të cilët nuk marrin pjesë drejtë për së drejti ose të cilët kanë pushuar së marrë pjesë në veprime ushtarake, pavarësisht nëse liria e tyre është apo nuk është kufizuar, kanë të drejtën e respektit të personit të tyre, nderit, bindjet dhe praktikat fetare. Në të gjitha rrethanat ata duhet të trajtohen njerëzishëm, pa asnjë ndarje të pafavorshme. Është e ndaluara të urdhërohet se nuk do të ketë të gjallë.

2. Pa paragjykimë në përgjithësimin e të lartpërmendurës, aktet në vijim kundër personave të adresuar në paragrafin I janë dhe duhet të mbeten të ndaluara në çfarëdo kohe dhe çfarëdo qoftë vendi:

(a) dhuna ndaj jetës, shëndetit dhe mirëqenies fizike ose mentale të personave, në veçanti vrasja si edhe trajtimi mizor sikurse është tortura, gjymtimi ose ndonjë form e ndëshkimit trupor;

(b) ndëshkimet kolektive;

(c) marrja e pengjeve;

(d) aktet e terrorizmit;

(e) mizorit mbi dinjitetin personal, në veçanti poshtërimi dhe trajtimi degradues, dhunimi, prostitucioni i detyrueshëm, dhe cilado form e sulmit jo të pëlqyer;

(f) skllavëria dhe tregtimi i robëve në të gjitha format e tyre;

(g) grabitja;

(h) kërcënimi për të bërë ndonjë nga aktet e lartpërmendura.

3. Fëmijëve duhet tu sigurohet kujdesi dhe ndihma të cilën e kërkojnë, dhe në veçanti:

(a) ata duhet të marrin shkollimin, duke përfshirë edukimin fetar dhe moral, duke i mbajtur me dëshirat e prindërve të tyre, ose në mungesë të prindërve, të atyre që janë përgjegjës për kujdesin e tyre;

(b) duhet të ndërmerren të gjithë hapat e duhur për të lehtësuar ribashkimin e familjeve të ndarë përkohësisht;

(c) Fëmijët të cilët nuk kanë mbushur moshën pesëmbëdhjetë nuk duhet as të rekrutohen në forcat e armatosura ose grupe e as të lejohen të marrin pjesë në veprime ushtarake;

(d) mbrojtja e veçant e paraparë me këtë Nen për fëmijët të cilët nuk e kanë mbushur moshën pesëmbëdhjetë vjeçare duhet të mbetet e aplikueshme për ta nëse kanë marrë pjesë drejtë për së drejti në veprime ushtarake përkundër dispozitave të nën paragrafit (c) dhe janë të zënë rob;

(e) nëse është e domosdoshme, masat duhet të ndërmerren, dhe kurdo që është e mundshme me pëlqimin e prindërve të tyre ose personave të cilat me ligj ose traditë janë kryesisht përgjegjës për kujdesin e tyre, për të larguar fëmijët përkohësisht nga vendi në të cilin janë duke u zhvilluar veprimet ushtarake në një vend më të sigurt brenda vendit dhe të sigurohet se ata janë në shoqërim të personave përgjegjës për sigurinë dhe mirëqenien e tyre.

Neni 5. Personat liritë e të cilëve janë kufizuar

1. Veç dispozitave të Nenit 4 dispozitat e mëposhtme duhet të respektohen minimum në lidhje me personat e privuar nga liria e tyre për arsyet e ndërlidhura me konfliktin e armatosur pavarësisht se a janë ata të internuar apo të burgosur;

(a) të plagosurit dhe të sëmurët do të trajtohen në përputhje me nenin 7;

(b) personat e përmendur në këtë paragraf, në të njëjtën masë sikurse popullata vendore civile, do të pajisen me ushqim dhe ujë të pijshëm dhe do të ofrohet garanci për sa i përket shëndetit dhe higjienës dhe mbrojtjes kundër masave të rrepta të klimës dhe të rreziqeve nga konflikti i armatosur;

(c) ata do të lejohen të marrin ndihmë individuale ose kolektive;

(d) ata do të lejohen të ushtrojnë fenë e tyre dhe nëse kërkohet dhe është e përshtatshme të marrin ndihmë shpirtërore nga personat siç janë klerikët që kryejnë ceremonitë fetare;

(e) nëse do të bëheshin për të punuar, ata do të kanë përfitim të kushteve të punës dhe të masave mbrojtëse të ngjashme me ato që gëzon popullata vendore civile”.

94. Gjykata e rigjykimit të shkallës së parë në aktgjykimin e saj të kundërshtuar dhe në lidhje m çështjen në fjalë ka shtjelluar në mes tjerash si në vijim:

“Gjykata Supreme ... vëren që ka qenë detyrë e trupit gjykues që të krahasojë gjendjen shëndetësore dhe të sigurisë të civilëve të paraburgosur me ato të popullatës në përgjithësi. Vetëm duke e kryer këtë krahasim, standardi i vendosur nga neni i përbashkët 3 i Konventave të Gjenevës dhe dispozitat përkatëse të Protokollit II, neni 5 (1), përmbushet. Duke e lënë mënjanë krahasimin e përmendur, trupi gjykues i ka vërtetuar faktet në mënyrë jo të plotë.

... Duhet kuptuar që kjo Gjykatë nuk e ka mundësinë tani që të ketë njohuri të drejtpërdrejtë për kushtet në të cilat janë mbajtur të paraburgosurit në Llapashticë: dhjetë vite më vonë, është thjeshtë joreale që të shpresohet që lokalet kanë mbetur të paprekura dhe që ato mund të japin një ide të vërtetë për situatën në të cilën njerëzit të cilëve iu ishte privuar liria kanë jetuar në qendrën e paraburgimit. Trupi gjykues ka përjashtuar vizitën në vendngjarje, për të shmangur krijimin e një përshtypjeje të rreme.” ... Prandaj, kolegji ka vendosur “...që të përdoret njohuria dhe përshkrimi i fakteve dhe fotografive që i ka siguruar trupi i mëparshëm gjykues gjatë vizitës së tij (ato janë në dosje dhe janë treguar në Gjykatë gjatë një seance të këtij shqyrtimi gjyqësor). ... Gjykata Supreme është mbështetur në to, nuk i ka kontestuar ato dhe i ka marrë si vlerësim të sinqertë dhe të saktë të kushteve të ndërtesës në të cilën janë mbajtur në paraburgim viktimat.” ... Gjykata e rigjykimit të shkallës së parë në veçanti i referohet faqes 46 të aktgjykimin të parë të datës 16 korrik 2003 ku thuhet “edhe në mes të ditës verore kur është mbyllur dera e hyrjes brendësia ka qenë tërësisht e errët ... Dhoma ka qenë e lagësht dhe me dimensione që janë vlerësuar të jenë 3 me 4 metra” (fq. 221 dhe 21 të versionit në gjuhën angleze).

Aktgjykimi përkatës i shkallës së parë vazhdon të shtjellojë gjetjet që janë vërtetuar nëpërmes një numri të dëshmitarëve nga të dyja anët, ish të paraburgosurit dhe ish gardianët, duke deklaruar që ka pasur furnizim të rregullt të sasive të mjaftueshme të ushqimit e gjithashtu të ujit dhe në rast të sëmundjes gjithashtu është siguruar trajtim shëndetësor për të dyja palët, pjesëtarët e UÇK-së dhe të paraburgosurve nga i njëjti mjek (fq. 22 dhe 23 i versionit në gjuhën angleze).

Megjithatë, gjykata e rigjyimit të shkallës së parë ka gjetur se dallimi në mes të popullatës civile në liri dhe të paraburgosurve në kushtet e standardeve jetësore siç kërkohet nga Protokollu II, neni 5, paragrafi (1) (a) i Konventës së Gjenevës “nuk mund të gjendet në kushtet që i janë imponuar viktimës së një transferimi të dhunshëm apo evakuimi” por më vonë, duke qenë “të ekspozuar ndaj trajtimit çnjerëzor... ata kthehen në objekte të një veprimi kriminal i cili degradon dhe poshtëron jetën e viktimave dhe prandaj këto kushte nuk mund të konsiderohen si përcaktues i standardit të një minimumi të dinjitetit jetësor për të paraburgosurit në Llapashticë...” (fq.23 e versionit në gjuhën angleze).

Pas referimit të hollësishëm në një numër të deklaratave të dëshmitarëve, Aktgjykimi i shkallës së parë vazhdon duke numëruar pikat e dallimit, të cilat sipas vlerësimit të Gjykatës e kanë bërë jetën e të paraburgosurve më të mjerë se sa të popullatës civile në liri. Në veçanti, i fundit ka pasur liri të mjaftueshme të lëvizjes dhe – nëse jo gjithashtu me bollëk – qasje në nxehje, rrymë dhe ujë e gjithashtu edhe vendet publike për qëllime afarizmi (fq.24 e versionit në gjuhën angleze).

95. Bazuar në atë që është nxjerr në pah para se të sqarohet pretendimi i Mbrojtjes, që gjykata e rigjyimit të shkallës së parë nuk e ka shtjelluar çështjen nëse kushtet jetësore të paraburgosurve kanë qenë në mënyrë të konsiderueshme më të këqija se sa ato të popullatës civile në liri, është i kotë. Që shtjellimet e Gjykatës së shkallës së parë kanë qenë të mjaftueshme sqarohet edhe më tepër duke e marr parasysh arsyetimin e lidhur me vendimin e Dhomës Gjyqësore II të TPNJ-së, “Prokurori kundër Fatmir Limaj et al”. TPNJ-ja lidhur me qendrën e paraburgimit në Llapushnik theksoi se “Është e qartë prej dëshmive të paraqitura në këtë gjykim, dhe Dhoma gjen se, kushtet materiale të paraburgimit [...]ishin tmerruese. Sipas këndvështrimit të Dhomës, në mënyrë të qartë rrjedh nga provat që ushqimi dhe uji nuk janë siguruar në mënyrë të rregullt, dhe se atje nuk kishte objekte të pastrimit, larjes apo atyre sanitare. Të dyja: stalla e lopëve dhe depoja nuk ishin të ajrosura në mënyrë adekuate dhe ndonjëherë ishin tepër të ngarkuara, posaçërisht depoja. Edhe pse të paraburgosurit ishin lejuar jashtë depos nganjëherë të jenë në gjendje që të kenë pak ajër të pastër, atmosfera dhe kushtet në dhomë mbetën të mjerueshme. Nuk ekzistonin objekte të fjetjes [...] gjë që është keqësuar nga mbushja e tepërt posaçërisht në depo[...] Asnjë trajtim mjekësorë nuk është siguruar edhe pse ishin në dispozicion. [...] Dhoma konstaton se kushtet e mjerueshme të paraburgimit në të dyja: në depo dhe në stallën e lopëve në kampin e burgut në Llapushnik, ishin të tilla që të shkaktojnë vuajtje të rënda mentale dhe fizike për të paraburgosurit dhe përbën sulm të rëndë në dinjitetin e të paraburgosurve. Për më tepër , periudha e caktuar gjithëpërfshirëse e kohës nëpër të cilat këto kushte janë mbajtur pa

përmirësime, Dhoma është e kënaqur që këto janë imponuar qëllimisht. Në gjetjet e Dhomës, paraburgimi si në stallën e lopëve apo në depo ishte në kushtet që përbëjnë veprë të akuzuar për trajtim mizor [...] (Ibid, supra fusnota 37, në paragrafët 288-289).

96. Për më tepër, sa i përket përgjegjësisë së të akuzuarit, analizat e vendimit përkatës të TPNJ-së është gjithashtu i dobishëm. Posaçërisht në lëndën “Prokurori kundër Milorad Krnojelac” (IT-97-25-A) i datës 17 shtator 2003, Dhoma e Apelit të TPNJ-së në mënyrë të qartë ka shtjelluar kërkesat që kanë të bëjnë me përgjegjësinë për kushtet jetësore në anët e kryesve të pretenduar të krimit. I akuzuari ka kundërshtuar që Dhoma Gjyqësore nuk ka specifikuar se cilat akte të tija konkrete dhe mosveprimet në mënyrë domethënëse kanë shtyrë persekutimin e bazuar në kushtet jetësore në vendin përkatës. Dhoma e Apelit të TPNJ-së ka vënë në pah që “është e mjaftueshme që [i akuzuari] me vetëdije dhe në mënyrë domethënëse ka kontribuar në mirëmbajtjen e kushteve jetësore” (fq.24 të versionit në gjuhën angleze).

97. Gjykata e rigjykimit të shkallës së parë deri më tani përfundon me përmbledhjen se “kushtet e paraburgimit në Llapashticë kanë qenë shumë më të ultë se sa kushtet e jetesës së popullatës në Podujevë dhe në rajonin përreth saj. ... I akuzuari ... ka pasur përgjegjësi të drejtpërdrejtë për qendrën e paraburgimit dhe lokalet përreth, N. Mehmuri është dashur që të i raportojë eprorit të tij (Rustem Mustafa) që lokalet ishin të mbushura plot e përplot dhe atyre i mungonin kushtet themelore për t'i mbajtur njerëzit të kufizuar. L. Gashi ka pasur qasje të drejtpërdrejtë dhe të pakufizuar në këtë qeli dhe i ka vizituar dhe marrë në pyetje dhe i ka rrahur të paraburgosurit, duke i raportuar drejtpërsëdrejti eprorit të tij, Rustem Mustafa” (fq.25 të versionit në gjuhën angleze).

98. Prandaj, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se gjykata e rigjykimit të shkallës së parë në mënyrë të mjaftueshme ka shtjelluar mbi dallimet në mes të kushteve jetësore të paraburgosurve dhe të popullatës civile në liri.

II. Gjetjet mbi përgjegjësinë personale të të akuzuarit, e posaçërisht të L. Gashi

99. Mbrojta ka kundërshtuar vërtetimin e gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike e posaçërisht në dëm të akuzuarit L. Gashi. Në mënyrë specifike një numër i konsideratave të gjykatës së shkallës së parë lidhur me format e përgjegjësisë penale të të akuzuarit do të ishin të diskutueshme. L. Gashi ka qenë i shpallur fajtor për pikat 5, 8 dhe 14 të aktakuzës dhe gjykata ka gjetur se ai sikurse edhe dy të akuzuarit tjerë – kanë vepruar me përgjegjësi personale dhe të eprorit për Krime Luftë në kundërshtim me nenin 142 i lidhur me nenin 22, 24, 26 dhe 30 të KP të RSFJ-së. Në veçanti, gjetjet përkatëse të gjykatës nuk do të mund të përkrahen nga çfarëdo provë e administruar gjatë Shqyrtimit Gjyqësor ose të marra gjatë periudhës hetimore.

100. Gjykata Supreme e Kosovës sa i përket kësaj gjen se asnjë vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike nuk mund të vërtetohet lidhur me sjelljen, marrjen dhe vlerësimin

e provave siç është kryer nga gjykata e rigjyimit të shkallës së parë në kontekstin e pikave 5 dhe 14. Megjithatë, prova lidhur me pikën 8 të aktgjyimit të kundërshtuar nuk është marr fare nga shkalla e parë dhe kështu që edhe vlerësimi nuk është bërë si duhet.

101. Siç tashmë është përmendur më herët (A.I.3., fq.14, pikat 36 ff. të këtij aktgjykimi), gjykata e rigjyimit të shkallës së parë nuk e ka marr parasysh aktgjykimin e gjyqtarit të parë, Gjykata e Qarkut të Prishtinës (P 425/01), e cila është revokuar në tërësi nga Gjykata Supreme përmes vendimit të saj përkatës Ap.-Kz. 139/2004. Në vend të kësaj, gjykata e ka interpretuar qëllimin e Gjykatës Supreme që vetëm pjesërisht të anuloi aktgjykimin e parë të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë. Ky interpretim është bërë përkundër formulimit të dispozitivit dhe duke marr parasysh bazat e aktgjyimit më të fundit. Edhe pse Gjykata Supreme e Kosovës nën aspektet e ndryshme – procedurale–ka vërtetuar që gjykata e rigjyimit të shkallës së parë ishte e lirë të marr pozitën ligjore të ndryshme nga opinioni i Gjykatës Supreme siç ishte formuluar në vendimin e saj Ap.-Kz. 139/2004 dhe se interpretimi i shkallës së parë deri më tani ishte gjithashtu në pajtim me ligjin (A.II.5., fq.29, pika 83 e këtij aktgjykimi), interpretimi i të fundit që të kufizohet në dënimin lidhur me pikën 8 deri më tani ka ndikim negativ në vlefshmërinë e aktgjyimit të kundërshtuar.

1. Sa i përket pikave 5 dhe 14

102. Gjykata Supreme e Kosovës, pas analizave të kujdesshme të shkresave të lëndës gjen se ekzistojnë baza të mjaftueshme për të gjetur të dyja përgjegjësi eprorë të secilit prej të pandehurve, së paku sa i përket pikës 5 dhe për përgjegjësinë personale të ~~Lutfi Gashi~~ lidhur me pikën 14. Asnjë tregues nuk mund të vërtetohet për të parandaluar gjetjen për përgjegjësinë personale apo atë të eprorit të personit/ave të caktuar ose në të dyja. Në veçanti krimet e luftës janë kryer në një situatë ku llojet e ndryshme të përgjegjësisë mund të bashkëveprojnë rrjedhshëm për shkak të situatës jo normale të krijuar nga lufta.

103. Sistemet ligjore kombëtare në përgjithësi pajtohen duke e zotëruar atë, ku krimi përfshin më tepër se një person, të gjithë duke e kryer veprën e njëjtë, të gjithë në mënyrë të barabartë janë të përgjegjës si bashkë kryes ose fajtorët kryesorë. Vetëm kur vjen tek dënimi i dy apo më tepër personave që marrin pjesë në krim, ku këta persona nuk e kryejnë të njëjtën vepër por në një mënyrë apo tjetrën i kontribuojnë në realizimin e planit penal, situata mbarë-kombëtare mund të trajtohet ndryshe.

104. Përderisa shumë sisteme (brenda Bashkimit Evropian për shembull Italia, Austria dhe Franca, por gjithashtu edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës) nuk parashikojnë fare për kategori të ndryshme të pjesëmarrësve, prandaj edhe nuk bashkëngjisin ndëshkime të ndryshme në secilën prej klasave qoftë të fajtorëve kryesorë apo të ndihmësve nën të cilat personi mundet përfundimisht të bie, sistemet tjera kombëtare ligjore (brenda Bashkimit Evropian, për shembull Gjermania, por gjithashtu edhe Rusia) tërheqin një dallim normativ në mes të dy kategorive, fajtorëve kryesorë dhe të bashkëfajtorëve apo ndihmësve, dhe parashikon kushte që personat që bien nën kategorinë më të fundit duhet të dënohen më butë. Megjithatë, dallimi zakonisht tërhiqet në të gjitha sistemet në mes të

tri kategorive të pjesëmarrjes, domethënë kryerjes në njërin anë dhe të përgjegjësisë së bashkëfajtorit në anën tjetër, i cili më vonë është ndarë në nxitje, ndihmë dhe përkrahje. Ky dallim është i bazuar qoftë në dallimin në mes të *actus reus* dhe *mens rea*, që rrjedh nga sistemet e ligjit anglosakson, ose – në versionin e tij normativ – nga sistemet e ligjit civil.

105. Në fushën e të drejtës ndërkombëtare (e cila mund të jetë relevante me qëllim të përcaktimit të parimeve drejtuese që qeverisin procedurën për Krimet e Luftës, aty ku është e përshtatshme) as traktate e as praktika gjyqësore nuk e bëjnë dallimin ligjor në mes të kategorive të ndryshme, së paku sa i përket ndëshkimeve pasuese. Kjo mungesë e dallimit vjen nga : i) mungesa e çfarëdo shkalle të pajtuar të ndëshkimeve të drejtës ndërkombëtare penale dhe nga ii) karakteri i përgjithshëm e këtij trupi ligjor, d.m.th., natyra e saj ende rudimentare dhe një mungesë tjetër e formalizmit.

106. Megjithatë, në Kosovë tradicionalisht dallimi bëhet siç u përshkruar më parë. Kjo *de lege lata* është reflektuar në Kodin Penal të Kosovës (KPK), e cila parashikon asnjë ndryshim të rëndësishëm në rastin e “Bashkëkryerjes” (neni 23 i KPK-së) dhe “Shtytjes” (neni 24 i KPK-së), por rregullat që “Ndihma” (neni 25 i KPK-së) dhe “Bashkimi Kriminal” (neni 26 i KPK-së) tani janë të ndëshkueshme më dënime më të buta.

107. Përgjegjësia e të akuzuarit **Lufti Gashi** në krimet për të cilat ai është shpallur fajtor – sikurse edhe për të gjithë të akuzuarit tjerë – duhet të vlerësohet në aspektin e dispozitave të lartpërmendura dhe, në veçanti, për shkak të veçantisë së krimit të paraparë nga neni 142 të KP të RSFJ-së, gjithashtu në aspektin e përgjegjësisë së eprorit të tij të mundshëm dhe atij personal, në lëndën e fundit gjithashtu duke marr parasysh teorinë e ndërmarrjes së përbashkët penale siç është paraqitur nga TPNJ-së si formë e veçantë e bashkëkryerjes.

108. Në lëndën në fjalë, aty ku ligji i vjetër jugosllav është ende i aplikueshëm, rezultati në kushtet e dënimit mund të jetë i njëjtë për kryesin dhe bashkëfajtorin sipas KP të RSFJ-së. Vlen të përmendet që në pajtim me nenin 22 të KP të RSFJ-së (Bashkë ekzekutimi) e gjithashtu në pajtim me nenin 23 paragrafit 1 të KP të RSFJ-së (Shtytja) të dyja format e pjesëmarrjes penale janë të “*dënueshme siç përshkruhet për veprën*”, përderisa për ndihmën në pajtim me nenin 24 të KP të RSFJ-së ligji i vjetër parasheh mundësinë e zvogëlimit të dënimit, e cila natyrisht nuk është e detyrueshme.

Neni 26 i KP të RSFJ-së i emëruar si “*Përgjegjësia penale dhe dënueshmëria e organizatorëve të shoqatave kriminale*”, të cilës aktgjykimi i kundërshtuar i shkallës së parë gjithashtu i referohet nuk parasheh ndonjë zbutje por më tepër e zgjeron përgjegjësinë e atyre që “*ka krijuar ose ka shfrytëzuar*” grupin kriminal për çfarëdo vepre penale që rezulton nga plani penal i grupit.

Përfundimisht, neni 30 i KP të RSFJ-së ka vërtetuar mundësinë e të qenit përgjegjës penalisht nga akti pozitiv ose nga mos veprimi. Kjo dispozitë e fundit mund të jetë një nga rregullat relevante që do të konsiderohet si nxitje e përgjegjësisë për Krimet e Luftës si një formë e përgjegjësisë komanduese, por jo edhe e vetmja.

109. Sa i përket **përgjegjesisë komanduese të akuzuarit**, referim i është bërë dënimit të TPNJ-së në lëndën “Prokurori kundër Vladimir Kovacevic” (*Trupit referues të TPNJ-së, Vendimi në Referimin e Lëndës në pajtim me Rregullën 11bis, Lënda IT-01-42/2-I (Prokurori kundër Vladimir Kovacevic), e datës 17 nëntor 2006, paragrafët prej 43 deri në 47*

(http://webcache.googleusercontent.com/search?q=cache:qDN6iHYXo00J:www.icty.org/x/cases/kovacevic_vladimir/tdec/en/061117e.pdf+referral+to+serbia+%2B+11+bis&cd=2&hl=en&ct=clnk).

110. TPNJ-ja ka përcaktuar që, është gjykata kompetente “[...] ajo që duhet të përcaktoj nëse koncepti i përgjegjesisë komanduese aplikohet qoftë përmes dispozitave të KP të RSFJ-së, Kodit të tanishëm Penal, ose si një normë e të drejtës ndërkombëtare zakonore [...] Koncepti i përgjegjesisë së komandës së "drejtpërdrejtë" në KP të RSFJ-së paraqitet shumë i kufizuar në nocionin e "urdhërimit," "organizimit" ose "nxitjes" së krimeve, i cili në (TPNJ – n.o.a.) jurisprudencën e Tribunalit bie në fushën e nenit 7(1) (të Statutit të TPNJ-së – n.o.a.) se sa në nenin 7(3) (të Statutit të TPNJ-së – n.o.a.). Për shembull, neni 142 i KP të RSFJ-së e përkufizon krimin jo vetëm kryerjen e krimeve të luftës kundër popullatës civile, por gjithashtu edhe duke urdhëruar krime të këtilla. Neni 145 e përkufizon krimin në organizimin e grupit me qëllim të kryerjes së krimeve të luftës kundër popullatës civile, ose për thirrje ose të nxis kryerjen e krimeve të tilla. Megjithatë, janë dispozitat tjera në KP të RSFJ-së të cilat paraqiten për të adresuar pjesët e fushës të mbuluar nga neni 7(3) (të Statutit të TPNJ-së – n.o.a.). Neni 11(2), për shembull siguron që kryesit janë përgjegjës për veprat penale të kryera nga pakujdesia, deri më tani pasi që vepra në fjalë është e ndëshkueshme nga ligji. Neni 30 i parashikuar për kriminalizimin e veprës së kryer me mosveprim nëse kryesi ka abstenuar nga kryerja e veprës të cilën ai ose ajo ishte i/e obliguar të kryej” (paragrafi 43 i vendimit në fjalë).

111. Përgjegjësia komanduese e të akuzuarit në lëndën në fjalë sqaron si plotësim sqaron aspektin e traditës legjislative në rajon e gjithashtu në Kosovë pasi që gjithashtu është reflektuar në veçanti nga neni 384 i Kodit Penal të tanishëm të Republikës së Serbisë (KP i S-së) sikurse nga neni 129 i KPK-së së tanishme. Në të dyja rastet ligji në mënyrë të qartë dhe në shumicën e pjesëve duke përdorur formulimin e njëjtë parashikon që komandanti ushtarak ose personi që në mënyrë efektive vepron si i tillë do të jetë penalisht përgjegjës për kryerjen e krimeve të ngjashme me atë që parashikon neni 142 i KP të RSFJ-së, që është kryer nën komandën dhe kontrollin e tij/saj efektive, edhe nëse ai/ajo kanë ditur vetëm se forcat ishin duke kryer ose duke i planifikuar ato ose në rastin kur ai/ajo ka dështuar të merr të gjitha masat e nevojshme dhe të arsyeshme brenda fuqive të tij/saj për të parandaluar apo ndaluar kryerjen e tyre. E njëjta gjë aplikohet për eprorët ndryshe nga të tjerët të definuar nga paragrafët përkatëse 1 të dispozitave të referuara.

Në këtë sfond është e nevojshme të nënvizohet që çështja e përgjegjesisë komanduese në konfliktet e brendshme të armatosura dhe aplikueshmëria e të Drejtës Zakonore Ndërkombëtare në Kosovë in Kosovo është shtjelluar në detaje nga aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë i datës 16 korrik 2003 (P 425/2001) dhe kjo pjesë e vendimit është konfirmuar nga Gjykata Supreme në vendimin e saj Ap.-Kz.139/2004, të cilin gjykata e

rigjykimit e shkallës së parë i është referuar (fq.22 deri në fq. 26 të versionit në gjuhën angleze të vendimit në fjalë).

112. Gjyqtari i parë në vendimin P 425/2003 në veçanti ka peshuar argumentet nëse E Drejta Ndërkombëtare Zakonore apo jo si burim i aplikueshmërisë së doktrinës së përgjegjesisë komanduese do të mund të ishte i aplikueshëm në Kosovë në lidhje me periudhën kohore në fjalë. Duke e marr parasysh se neni 210 i Kushtetutës së RSFJ-së të vitit 1974 ka lënë jashtë të Drejtën Ndërkombëtare dhe sipas nenit 1.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24, për më tepër Kushtetuta e RSFJ-se e vitit 1974 ishte më e favorshme për të pandehurin kështu që duhet të aplikohet nga gjykata, gjyqtari i parë erdhi në përfundim që megjithatë sa i përket nenit 142 të KP të RSFJ-së, E Drejta Ndërkombëtare Zakonore do të mund të jetë e aplikueshme në lëndën në fjalë. Duke e marr parasysh faktin se RSFJ-ja ka miratuar dhe zbatuar “[...] Konventat thelbësore mbi të Drejtat e Njeriut dhe zgjerimi i definicionit të drejtës ndërkombëtare në nenin 16 të Kushtetutës në vitin 1992 në mënyrë të qartë do të tregonte se qëllimi i legjislaturës ishte të përvetësoj dhe jo të refuzoj Të Drejtën Zakonore Ndërkombëtare” (fq.26 të versionit në gjuhën angleze të vendimit në fjalë).

Gjyqtari i parë gjithashtu i ka bërë referim jurisprudencës së TPNJ-së, e cila ” [...] mendon se shkeljet e të drejtës humanitare të konflikteve të brendshme arrijnë (përbëjnë) krime lufte të dhura si rezultat i evolucionit të rregullave zakonore në komunitetin ndërkombëtar me një shpjegim të arsyeshëm të kalimit gradual nga orientimi i shtetit sovran në qasjen e orientuar të qenieve njerëzore”. Prandaj, sipas gjyqtarit të parë do të jetë “[...] logjike të pranohet që procesi i njëjtë gradual ka shpie në pranimin e parimit të përgjegjesisë komanduese deri në pikën që tani është vendosur si rregull zakonore e të drejtës ndërkombëtare në konfliktet e jashtme e gjithashtu edhe në konfliktet e armatosura ndërkombëtare” (fq.24 dhe 25 e versionit në gjuhën angleze të vendimit në fjalë).

Në të vërtetë, në aktgjykimin e saj të datës 2 tetor 2009 (P 126/05), gjykata e rigjykimit të shkallës së parë e dënoi **Lionel Gashin** për pikat 5 dhe 8 të aktakuzës së ndryshuar të 30 qershorit 2003 duke ju referuar përgjegjesisë së tij personale dhe të eprorit (lexo “Komandë”). Gjykata theksoi se “[...] pika e formave të aplikueshme të përgjegjësive ishte konsideruar nga trupi gjykues kur ka vlerësuar përgjegjësinë e të akuzuarit për veprat e kryera penale; përfundimet e arritura nuk janë kthyer prapa nga Gjykata Supreme [...]” (fq. 17 i versionit në gjuhën angleze të aktgjykimit P 526/05) dhe veç kësaj pjesëmarrja e të pandehurit “në ndërmarrjen e përbashkët penale [...] thjesht identifikon modalitetin specifik të bashkëkryerjes së krimeve” (fq. 17 të versionit në gjuhën angleze të aktgjykimit P 526/05).

113. Gjykata Supreme e Kosovës deri më tani pajtohet në vijën e përgjithshme të argumentimit siç është formuluar më parë .

Në respekt të pikës së vetme, prej të cilës i akuzuari është shpallur fajtor, është bërë vlerësimi vijues:

114. Duke i referuar krimeve të kryera nën pikën 5, gjykata e rigjykimit të shkallës së parë ka theksuar që “shprehja ‘ndërmarrje e përbashkët penale’ [...] tregon në rrethana të caktuara, një dituri dhe dashje të përbashkët, apo pranim, të situatës; një gjendje psikologjike që reciprokisht ushqen dhe vërteton në mesin e atyre të cilët e ndajnë dhe përtej tyre, në komunitetin e ushtarëve, një tolerancë ndaj paligjshmërisë dhe një mungesë të disiplinës dhe përgjegjësisë” (fq. 25 të versionit në gjuhën angleze të aktgjykimit P 526/05).

Në këtë aspekt, duhet të nënvizohet që “ndërmarrja e përbashkët penale” siç është adresuar nga gjykata e rigjykimit në shkallën e parë është formë e kryerjes ose bashkëkryerjes e themeluar vendosmërisht në të Drejtën Ndërkombëtare Zakonore, e cila pranon tri kategori të ndryshme të veprave: (1) forma ‘themelore’ e ndërmarrjes së përbashkët penale e cila paraqitet nga lëndët ku të gjithë bashkëfajtorët, duke vepruar në pajtim me qëllimin e përbashkët, posedon qëllimin e njëjtë penal; (2) forma ‘sistematike’ një variant i formës së parë i karakterizuar nga ekzistenca e sistemit të organizuar penal, në veçanti në rastin e përqëndrimit ose të kampeve të paraburgimit dhe i cili kërkon njohuri personale të sistemit të organizuar dhe qëllimit të shtyj përpara qëllimin penal të atij sistemi (*Dhoma e Apelit të TPNJ-së, Prokurori kundër Vasiljevic, supra fusnota 36, në paragrafin 98; Dhoma e Apelit të TPNJ-së, Prokurori kundër Tadic, supra fusnota 36, paragrafët 202-203; Dhoma Gjyqësore II e TPNJ-së, Prokurori kundër Fatmir Limaj et al., supra fusnota 37*); dhe (3) forma që përmban përgjegjësinë për krimet e kryera përtej qëllimit të përbashkët por të cilat janë megjithatë pasojë natyrale dhe e parashikueshme e qëllimit të përbashkët.

Në rastin më të fundit, kërkesa *mens rea* për formën e zgjatur është e dyfishtë. Së pari, i akuzuari duhet të ketë qëllim të marr pjesë dhe të kontribuoj në qëllimin e përbashkët penal. Së dyti, me qëllim që të mbahet përgjegjës për krimet të cilat nuk ishin pjesë e qëllimit të përbashkët penal, por të cilat ishin megjithatë pasojë natyrale dhe e parashikueshme e saj, i akuzuari duhet gjithashtu të dijë që një krim i tillë mund të kryhet nga një pjesëtar i grupit, dhe me vetë dëshirë të merr rrezikun që krimi mund të ndodh duke iu bashkuar ose duke vazhduar të marr pjesë në ndërmarrje (*Dhoma e Apelit të TPNJ-së, Prokurori kundër Kvočka et al., supra fusnota 35, në paragrafin 83; shih gjithashtu Dhomën Gjyqësore II të TPNJ-së, Prokurori kundër Fatmir Limaj et al., supra fusnota 37, paragrafi 511 (i ngjashëm)*).

115. Tri format e “ndërmarrjes së përbashkët penale”, si formë e bashkëkryerjes fuqimisht e themeluar në të Drejtën Zakonore Ndërkombëtare siç tashmë është shtjelluar nga aktgjykimi i gjyqtarit të parë të datës 16 korrik 2003 (P 425/2001) (fq. 22 deri 26 të versionit në gjuhën angleze të vendimit në fjalë) është formë shtesë e përgjegjësisë dhe si e tillë është marr në konsideratë nga Gjykata Supreme e Kosovës në lëndën në fjalë në mënyrë që të identifikoj më mirë përgjegjësitë e të tre të pandehurve për disa nga krimet për të cilat janë dënuar.

116. Në kontekstin e dhënë, megjithatë është e rëndësishme të vërehet se edhe pse **L.116** **G.116** gjithmonë e ka mohuar pjesëmarrjen në Komandën e Zonës së Rajonit të Llapit në

vendimet relevante që kanë të bëjnë me fatin e personave të mbajtur në kampet e ndryshme të paraburgimit, ai ka theksuar gjatë seancës gjyqësore të datës 8 korrik 2009 që “[...]zona operative e Llapit ka funksionuar si një SHP (Shtab i Përgjithshëm)HQ” dhe që “kjo zonë ka pasur linjë vertikale dhe të drejtpërdrejtë në mes të sektorëve të ndryshëm, zëvendësin dhe pastaj komandantin”. Ai më tutje theksoi se “rrethanat e imponuara në SHP për marrjen e vendimit” për paraburgimin e disa njerëzve që dyshohen që kanë bashkëpunuar me armikun por ai gjithmonë fliste sikurse vendimi të jetë marr nga SHP-ja “mos me u marr me ta ” në të cilën përfshirja e tij ishte anësore apo mungonte fare. (Procesverbali i datës 8 korrik 2009, fq. 8, 10 dhe 11 e versionit në gjuhën angleze)

117. Megjithatë, i pandehuri **N. Mehmeti**, i cili ishte përgjegjës për mbajtjen e objektit të paraburgimit në Llapashicë, gjatë seancës gjyqësore të datës 9 korrik 2009, kur është pyetur kush ishte nën Komandën e Zonës, u përgjigj “**Rustem Mustafa** [...] K. K. [...] N. [...] [...]” dhe “tre komandantët e brigadave së zonës dhe [...] zëvendës komandantët e brigadave” 151, 152 dhe 153, duke përfshirë “Shefin e Shërbimit Informativ”, domethënë vetë **Latif Gashi** (Procesverbali i datës 9 korrik 2009, fq. 21 të versionit në gjuhën angleze).

2. Pika e 14 në veçanti: Mungesa e besueshmërisë dhe përgjegjësisë së dëshmitarëve e konsideruar pozitivisht nga gjykata e shkallës së parë

118. Duke iu referuar pikës 14 të aktakuzës së ndryshuar të 30 qershor 2003, Gjykata Supreme e Kosovës vëren se gjykata e rigjyqimit të shkallës së parë ka vlerësuar deklaratën e viktimës M. S. si të besueshme. Pas shqyrtimit të vendimit të Gjykatës Supreme Ap.-Kz. 139/2004 deri në këtë nivel dhe pas vlerësimit të rëndësisë së pikës 14 të aktakuzës në lidhje me përgjegjësinë që tashmë është konstatuar në pjesën për të akuzuarin **Latif Gashi**, gjykata e rigjyqimit të shkallës së parë vjen tek përfundimi që “pika 14 është një akuzë autonome” ... duke përfshirë “një histori unike të brutaliteteve”. Aktgjykimi i kundërshtuar nxjerr në pah që edhe pse dëshmitari M. S. “[...] nuk ishte në gjendje të identifikoj **Latif Gashin** në gjykatë [...] kjo nuk cenon besueshmërinë e tij”. Gjykata, pas sjelljes së arsyeve për vlerësimin e tyre për besueshmërinë e M. S., i cili i referohet qasjes së tij të qenit person i thjeshtë dhe i ndershëm, për më tepër deklaroi se “sipas opinionit të kolegjit dëshmia e tij [gjithashtu] ishte e besueshme dhe mjaft e qartë, duke marr parasysh se 10 vite kishin kaluar”. Gjithashtu ky vlerësim i deklaratës së dëshmitarit është minuar nga arsyetimi i detajuar pas kësaj, duke nënvizuar që fjalimi i tij ishte i koncentruar rreth disa pikave mbi të cilat memoria e tij ishte ende e gjallë e gjithashtu që dëshmia e tij do të përputhet me deklaratat e dhëna në vitin 2002 para gjyqarit hetues dhe në vitin 2003 të dhëna para gjyqarit të parë të shqyrtimit gjyqësor dhe faktit që dëshmitari nuk ka treguar paqartësi serioze gjithashtu gjatë marrjes në pyetje nga ana kundërshtare nga Mbrojtja (fq.28 e versionit në gjuhën angleze).

119. Prandaj, Gjykata Supreme e Kosovës nuk gjen asgjë të kundërshtoj në lidhje me këtë pjesën e fundit të aktgjykimit të kundërshtuar, kështu në veçanti duke iu referuar provave të marra dhe vlerësimeve të tyre.

120. Sa i përket marrjes dhe vlerësimit të provave nga gjykata e rigjykimit të shkallës së parë, referencë është bërë në vendimin përkatës të Gjykatës Supreme të Kosovës siç formuluar në disa vendime në lëndët ku kolegji i ankesave ka zgjedhur mos të marrë asnjë provë të re. Në të gjitha këto raste Gjykata Supreme ka vërtetuar që të gjeturat dhe vlerësimet e trupit gjykues duhet të konsiderohen si detyruese për shkallën e ardhshme. Në veçanti në lëndën e **Rimova, Argjani dhe Doma** (Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZ 477/05, 25 janar 2008) Gjykata Supreme në mënyrë të qartë deklaroi se *“Procedurat ankimore në KPPK-së qëndrojnë në parimet që i mbetet trupit gjykues të dëgjoj, vlerësoj dhe të peshoj provat në gjykim [...] Prandaj, gjykata e nevojitet ti jap trupit gjykues kufizim të respektit në arritjen e gjendjeve faktike. Nuk do të duhej të pengoj gjetjet e trupit gjykues që ti zëvendësoj me të sajat, përveç që provat mbështetura nga trupi gjykues nuk kanë mundur të pranohen nga çfarëdo gjykatë e arsyeshme e faktit, ose aty ku vlerësimi i saj ka qenë ‘tërësisht i gabueshëm’ ” (fq. 20, e versionit në gjuhën angleze). Gjithashtu në lëndën e **Vladimir Utaje, Robert Sylajit dhe Sabri Islami** (Ap-Kz 428/2007, të datës 28 maj 2007) Gjykata Supreme ka sqaruar se *“Gjykata Supreme e Kosovës duhet të shtyjë vlerësimin nga trupi gjykues për besueshmërinë e dëshmitarëve gjyqësorë që u paraqitën personalisht para tyre dhe të cilët dëshmuuan personalisht para tyre. Nuk është e duhur për Gjykatën Supreme të Kosovës mos pranoj vlerësimin e trupit gjykues për besueshmërinë e atyre dëshmitarëve vetëm nëse ka baza të forta për ta bërë atë [...]” (fq.24 e versionit në gjuhën angleze). Përfundimisht, ky vendim është përsëritur në lëndën e **Josin Klajin** (Ap.-Kz. 84/2009, të datës 3 dhjetor 2009), në të cilën Gjykata Supreme e Kosovës gjeti se *“[...] nuk është as në kompetencë të kolegjit të apelit e as e mundshme në fakt të zëvendësoj gjetjet e Gjykatës së shkallës së parë, e posaçërisht jo pa i marr të gjitha provat përsëri” (fq. 19 të versionit në gjuhën angleze).***

121. Përveç kësaj, përmenden edhe komentet përkatëse të ligjit të vjetër që ka qenë në fuqi për këtë rast, sipas të cilëve *“gjykata e shkallës së dytë nuk ka kompetenca që, në bazë të shkresave të lëndës, në seancën e kolegjit, përmes vlerësimit vetjak të dëshmimeve të cilat janë paraqitur nga gjykata e shkallës së parë, të konstatojë gjendje tjetër faktike dhe duke ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë të lirojë të akuzuarin nga akuzat (Gjykata Supreme e Jugosllavisë, Kz 24/61 e datës 29 mars 1961; KZ 93/62 e datës 21 nëntor 1962; Gjykata Supreme e Maqedonisë Kz 7/82 e datës 7 prill 1982).” (Branko Petric; Komente për Ligjin mbi Procedurën Penale; 1986; botimi i dytë; Gazeta Zyrtare e RSFJ-së; Beograd; Neni 387; pika II. 8), faqe .223).*

122. Duhet të shqyrtohet gjykimi përkitazi me vlerësimin e dëshmisë së dëshmitarëve të ndryshëm të dëgjuar nga rigjykimi në gjykatën e shkallës së parë dhe, në veçanti, lidhur me gjetjet e trupit gjykues pas dëgjimit të palës së dëmtuar M S

Në fund, Gjykata Supreme e Kosovës pajtohet me vlerësimin e përgjithshëm të dëshmimeve të kryer në rigjykimin e gjykatës së shkallës së parë, i cili shpui në dënimin e **L.**

G... për veprimet e nënvizuara në pikat 5 dhe 14 dhe të N... Mehmeti dhe të R... Mehmeti në pikën 5 të aktgjykimit të kundërshtuar.

3. Lidhur me Pikën 8

123. Përkitazi me Pikën 8 të Aktgjykimit të kundërshtuar, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se Rigjykimi në gjykatën e shkallës së parë vërtet nuk ka marrë të gjitha provat prandaj nuk ka kryer si duhet vlerësimin e saj.

124. Gjykata e shkallës së parë deklaroi se: *“përgjegjësia e tre të akuzuarve është konstatuar dhe është vërtetuar gjatë fazës së mëhershme të gjykimit”* (faqe 26 e versionit në gjuhën angleze) dhe se trupi ri-gjykues e ka marrë këtë parasysht.

Në këtë kuptim, vlen të përmendet se gjatë seancave gjyqësore të datës 8 dhe 9 korrik 2009 të tre të akuzuarit natyrisht kanë konfirmuar përgjegjësitë e tyre brenda UÇK-së dhe atë çfarë e kishin thënë gjatë fazave të mëhershme të hetimeve dhe gjykimit.

Megjithatë, Gjykata e shkallës së parë ka përcaktuar rolin e saj rreth pikës 8 të aktakuzës si *“të kufizuar në dënimin të cilin Gjykata Supreme e ka konstatuar të përjashtohet vetvetiu, duke u bazuar në interpretimin e dhënë në Nenin 385 të LPP-së në faqen e fundit të vendimit të saj. Uniteti i treguar nga trupi gjykues për të gjitha faktet në një krim të vetëm të luftës është konsideruar nga Gjykata Supreme si një kufizim për zbatimin e nenit 367 të LPP-së dhe për shpalljen e vendimit që përcakton dënimin e duhur për faktet e përshkruara në pjesën tjetër të Pikës 8 (rrahjet dhe tortura e Llapashticës [...])”* (f. 13 në versionin në gjuhën angleze).

125. Ky interpretim i kryer gjatë rigjykimit nga gjykata e shkallës së parë konsiderohet juridikisht i papranuar. Gjykata Supreme e Kosovës natyrisht e ka të qartë që kolegji përkatës i Gjykatës Supreme gjatë marrjes së vendimit Ap-Kz 139/2004 mbi anulimin e Aktgjykimit të parë të Gjykatës së Qarkut (425/2001) është udhëhequr nga interpretimi i gjyqtarit të shkallës së parë të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës i Nenit 142 të KP të RSFJ-së duke e përshkruar si “vepër të zgjeruar penale” dhe prandaj ka anuluar në tërësi Aktgjykimin përkatës, dhe si pasojë e kësaj e ka kthyer tërë lëndën për rigjykim.

Gjykata Supreme lidhur me këtë pikë të veçantë, ka paraparë që *“aktgjykimi ka trajtuar pikat e ndryshme në aktakuzën e ndryshuar të datës 30 qershor 2003 si një krim të vetëm të luftës për secilin të pandehur. [...] duke i trajtuar këto pika si një krim të vetëm të luftës dhe duke i shqiptuar dënimet përkatëse; Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka zgjidhje tjetër pos të kthejë prapa për rigjykim lëndën në tërësi, duke u mbështetur në Nenin 385, par. 1 të LPP-së [...]”* (Gjykata Supreme në Vendimin Ap-Kz 139/04, faqja e fundit e vendimit).

Është po ashtu e qartë se Gjykata e shkallës së parë gjatë rigjykimit nuk është detyruar me këtë interpretim juridik të Gjykatës Supreme prandaj ka qenë e lirë për t’u marrë me vepra të ndryshme të të akuzuarve si incidente të ndara të krimit të luftës, secili nga ta i

dënueshëm në vetvete, pozitë kjo e cila ndahet edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës lidhur me rastin në fjalë.

Gjykata Supreme e Kosovës po ashtu pajtohet me gjetjet e gjykatës së shkallës së parë gjatë rigjyimit, të cilat kufizojnë rigjykimin e vetëm atyre pikave të paprekura me vendimin e Gjykatës Supreme Ap-Kz 139/2004, pasi që *"vendimi i Gjykatës Supreme lidhur me faktet e lidhura për pikat 1, 2, 3, 12 është res judicata dhe për këtë arsye faktet e përshkruara aty nuk mund të jenë objekt trajtimi i ekzaminimit të mëtejshëm gjyqësor"* (faqe 11 e versionit në gjuhën angleze).

126. Megjithatë, vendimi i Gjykatës Supreme nuk mund të interpretohet në kundërshtim me formulimin shumë të qartë të dispozitivit, duke pohuar se vendimi i gjyqtarit të shkallës së parë është *"ANULUAR DHE PRISHUR NË TËRËSI ndërsa lënda është kthyer prapa për rigjykim"* (faqe 2 e versionit në gjuhën angleze të Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ap-Kz 139/2004).

Duke pasur këtë parasysh, Gjykata e shkallës së parë në rigjykim është parandaluar të mbështetet vetëm në gjetjet e gjyqtarit të shkallës së parë lidhur me pikën 8 – edhe pse provat janë marrë dhe janë vlerësuar në mënyrë të rregullt.

III. Dështimi i Gjykatës së shkallës së parë për ta ndarë Deklaratën e Dëshmitarit '4' nga shkresat e lëndës

127. Mbrojtja për më tepër ka kundërshtuar mosveçimin e dëshmisë së dëshmitarit anonim '4' nga shkresat e lëndës, sipas Neneve 83 dhe 84, lidhur me Nenin 333, par. 3 të LPP-së dhe jo vetëm leximin e saj në rigjykimin e shkallës së parë.

128. Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se pretendimi i mbrojtjes është jomeritor.

Dëshmitari anonim '4' ka deklaruar para Gjyqtarit hetues më 18 tetor 2002, duke iu referuar rolit të **L. G.** që e kishte qar dëshmitarin në burgun e Llapashticës ku dëshmitari '4' ishte rrahur nga Policia ushtarake. Pas kësaj, i akuzuari **L. G.** iu kishte thënë Policisë ushtarake që *"ky ishte personi që rri me serbë"* (faqe 3 e versionit në gjuhën angleze të Procesverbalit të seancës dëgjimore të dëshmitarit më 18 tetor 2002).

129. Neni 83 i LPP-së lidhur me këtë rast përcakton si më poshtë:

(1) Kur ky ligj përcakton që vendimi i gjykatës nuk mund të mbështetet mbi dëshminë e [...a...] dëshmitarit [...], gjyqtari hetues vendos sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palëve për veçimin e transkriptit të asaj dëshmie nga procesverbali menjëherë por jo më vonë sesa hetimi të përfundojë ose gjyqtari hetimor të japë pëlqimin që aktakuza mund të ngritet edhe pa zhvillimin e hetimeve (Neni 160, par. 1). [...].

Neni 84 i LPP-së lidhur me këtë rast përcakton si më poshtë:

(1) Në raste të jashtëzakonshme, të dhënat dhe informatat e hequra sipas dispozitave të Nenit 83 të këtij Ligji, mund të përdoren në gjykim [...] vetëm në rastet:

1) kur i pandehuri personalisht kërkon leximin e materialit të hequr nga procesverbali [...]

2) kur, gjatë gjykimit, pas marrjes së të dhënave personale, kolegji i gjyqtarëve vendos të lejojë përdorimin e procesverbalit mbi marrjen në pyetje të të pandehurit, i cili është veçuar gjatë procedurës vetëm për shkak të shkeljes së dispozitës së Nenit 218, par. 9 të këtij Ligji, si dhe të informatave të dhëna nga i pandehuri para organeve për zbatimin ligjit. [...].

Neni 333, par. 3 përcakton që “Procesverbali i dëgjimit paraprak të dëshmitarëve (Neni 227) mund të mos lexohet po qe se ata persona nuk janë ftuar fare në shqyrtim gjyqësor ose nëse ata deklarojnë gjatë shqyrtimit gjyqësor se refuzojnë për të dëshmuar si dëshmitarë [...]”

130. Duhet të nënvizohet se dispozita qartë u referohet vetëm personave të përmendur në Nenin 227 të LPP-së, përkatësisht bashkëshortit apo bashkëshortes, të afërmve sipas gjakut ose të afërmve në vijë anësore deri në brezin e tretë, të afërmve sipas gjinisë deri në brezin e dytë, të fëmijëve të birësuar ose të prindërve birësues, por të gjithë këta të lidhur me të akuzuarin, brenda të cilëve nuk bën pjesë Dëshmitari ‘4’. Për këtë arsye, gjykata e shkallës së parë gjatë rigjykimit nuk ka shkelur Nenin 333, par. 1 të LPP-së me leximin e deklaratave të Dëshmitarit ‘3’.

Pretendimi i marrjes jo të drejtë në pyetje të dëshmitarit:

131. Ankesa e Avokatit mbrojtës në emër të L. G. për më tepër pretendon se më 15 maj 2002 dëshmitari është marrë në pyetje nga gjyqtari hetues në prani të policit i cili po udhëhiqte hetimet dhe se më 18 dhjetor 2002 gjatë marrjes në pyetje nga ana e gjyqtarit hetues, dëshmitari kishte lexuar procesverbalin e marrjes në pyetje të datës 14 maj 2002, përkundër faktit se gjatë shqyrtimit gjyqësor para gjyqtarit të shkallës së parë në seancën e 20 marsit 2002 ai kishte mohuar këto deklaratatë të mëhershme si të pavërteta (faqe 10-11).

132. Përmendet çështja lidhur me provat, e cila duhet të shqyrtohet dhe të vlerësohet nga gjykata që drejton shqyrtimin gjyqësor dhe si rregull kjo gjë nuk mund të rivlerësohet nga Gjykata e Apelit duke u mbështetur vetëm në shkresat e lëndës (B.II.2., faqe 41-42, pika 122 e këtij Aktgjykimi). Për këtë arsye, Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka qëndrim lidhur me vlerësimin e provave të kryer nga trupi ri-gjykues i shkallës së parë.

Megjithatë, duhet të përmendet që ndërmjet 20 marsit dhe 8 majit të vitit 2003, trembëdhjetë (13) dëshmitarë të prokurorisë kanë dëshmuar para gjyqtarit të shkallës së parë gjatë shqyrtimit gjyqësor në lëndën P 425/01, prej të cilëve tre kanë gëzuar masa mbrojtëse si dëshmitarë anonimë në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/20 Për Mbrojtjen e Palëve të Dëmtuara dhe të Dëshmitarëve në Procedurën Penale (të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2002/1), e cila u jep kompetenca trupave

gjykues në Kosovë që të kufizojnë zbulimin e identitetit të dëshmitarit në rastet kur perceptohet se nëse nuk bëhet një gjë e tillë dëshmitari apo familja e tij/ e saj mund t'i nënshtrohet ndonjë dëmi të mundshëm fizik. Pa asnjë përjashtim të gjithë dëshmitarët janë dëgjuar në seanca të mbyllura për publikun.

Sa i përket shqetësimit të mundshëm të Mbrojtjes se nuk i është dhënë sa duhet mundësi për ta marrë në pyetje Dëshmitarin '4' ballë për ballë, përsëri i referohemi Rregullores së lartpërmendur të UNMIK-ut nr. 2001/20 (të ndryshuar me Rregulloren 2002/1). Interesi i dëshmitarit në fjalë dhe i familjes së tij/ saj mbrohet me këtë Rregullore të UNMIK-ut, megjithatë, kjo duhet të balancohet me të drejtën e të akuzuarit dhe të mbrojtjes për t'i marrë në pyetje dëshmitarët.

Gjithashtu, me qëllim të përcaktimit të besueshmërisë së dëshmitarit, është me rëndësi për gjykatën që të jetë në gjendje të vlerësojë qasjen e dëshmitarit – dhe që të jetë në gjendje të shohë fizikisht dëshmitarin. Kështu, zbatimi i masave mbrojtëse natyrisht kërkon kujdes.

Megjithatë, Gjykata Supreme e Kosovës me këtë është e kënaqur që gjykata e shkallës së parë në rigjykim ka peshuar si duhet të dyja këto interesa. Është procedurë normale që dëshmitari anonim të merret në pyetje, por jo ballë për ballë, për shkak të mbrojtjes së dëshmitarit në fjalë.

Megjithatë, edhe po qe se gjyqtari i shkallës së parë asokohe nuk ka zbatuar procedurën më të favorshme gjatë dëgjimit të dëshmitarëve anonimë prej kabinës në largësi, duke ia pamundësuar vetë trupit gjykues shikimin e dëshmitarëve dhe vlerësimin e drejtë të besueshmërisë së tyre, duhet që të vërtetohet nëse rëndësia e deklaratës së tillë është kufizuar edhe më shumë nga fakti që dëshmia e dhënë nga ky dhe të tjerë dëshmitarë anonimë, nëse ka pasur ndonjë rëndësi, ka të bëjë edhe me dëshmitarët e tjerë, por që nuk ka përbërë bazën e vetme për të provuar cilëndo pikë.

IV. Pohimi mbi përcaktimin e gabuar të kohës së kaluar në UÇK të të Akuzuarit N. Mehmeti si dhe të rolit të tij në burg

133. Sa i përket të akuzuarit N. Mehmeti, mbrojtja ka pretenduar për dallim nga Aktgjykimi i shkallës së parë se Mehmeti nuk i është bashkuar UÇK-së nga "tetori 1998 deri në fund të prillit 1999", por se ka qenë anëtar i UÇK-së saktësisht më 30 tetor 1998. Gjykata e shkallës së parë për më tepër nuk ka marrë parasysh faktin që Mehmeti – brenda mundësive të veta – kishte përmirësuar gjendjen e objektit ku mbaheshin të paraburgosurit. Përfundimisht, gjykata – lidhur me Pikën 8 të aktakuzës – kurrë nuk ka dëgjuar asnjë deklaratë të ndonjë dëshmitari se i akuzuari N. Mehmeti kishte urdhëruar ose kishte marrë pjesë në rrahje apo në torturimin e të burgosurve shqiptarë.

134. Lidhur me kohën kur i akuzuari i ishte bashkuar UÇK-së, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se ky argument është i parëndësishëm. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë gjatë rigjyqimit vërtet nuk ka përcaktuar periudhën përkatëse duke filluar nga 1

tetori 1998. Gjithashtu, duhet të përmendet se 30 tetori 1998 është ende pjesë e tetorit, prandaj gjetjet e gjykatës së shkallës së parë janë të sakta përkundër faktit që një përkufizim më i saktë i periudhës përkatëse kohore nuk do të kishte sjellë asnjë ndryshim në vlerësimin e dëshmimeve dhe në përgjegjësinë e konstatuar të të akuzuarit.

Lidhur me argumentet e ngritura nga mbrojtja përkitazi me mungesën e pohuar të rolit (apo të rolit marginal) të N. MUSTAFI në sistemin e burgut të kampit, një gjë e tillë përmendet në procesverbalin e datës 9 korrik 2009 (faqe 6), sipas të cilit i akuzuari personalisht ka deklaruar se asokohe ai kishte zgjedhur dikë tjetër (dëshmitarët G. Z. dhe K. H.) si roja të të burgosurve.

V. Pohimi mbi vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike për shkak të karakterit politik të procedurës penale kundër të akuzuarit Rustem Mustafa në raport me ekzistimin e burgut në Llapashticë

135. Mbrojtja e Rustem Mustafës pretendoi se në raport me pikën 5 të aktakuzës së ndryshuar të datës 30 qershor 2003, kurrë nuk është vërtetuar nga Gjykata se procedura penale kundër klientit të tij kishte filluar shtatë muaj më vonë sesa procedura kundër dy të akuzuarve të tjerë dhe se arsye për këtë është fakti që Rustem Mustafa ka qenë Komandant i ZOLL-it, duke shpallur kështu publikisht se në zonën e përgjegjësisë së tij nuk kishte pasur krime të luftës kundër popullsisë civile. Për këtë arsye, procedura penale kundër tij ka karakter politik. Për më tepër, në Llapashticë nuk ka pasur as burg as qendër paraburgimi, siç pohohet nga të akuzuarit, por kjo nuk është marrë parasysh nga Gjykata e shkallës së parë. Plot deklarata të dëshmitarëve se Rustem Mustafa kishte urdhëruar lirimin e personave të burgosur, janë injoruar nga Gjykata e shkallës së parë.

136. Gjykata Supreme konstaton se pretendimet e mbrojtjes janë jomeritore dhe për këtë arsye të pabaza. Ajo që u tha më lart është përmendur në kuptimin e burgut në Llapashticë dhe për kushtet jetësore të të burgosurve që kanë qenë aty (pika A. III. 4. 1), faqe 34-35). Duke u bazuar në gjetjet e shqyrtuara aty, Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka asnjë dyshim se ka ekzistuar një burg i këtillë në zonën në fjalë gjatë periudhës kohore në fjalë. Kjo, për më tepër, është konfirmuar nga vetë Rustem Mustafa, i cili ka thënë: *“është e vërtetë se [...] ne e kemi pranuar se zonën tonë ka pasur raste të izolimit të personave, duke i privuar të njëjtit nga liria dhe ndërkombëtarët kanë qenë në dijeni lidhur me këtë [...]”* (procesverbali i marrjes në pyetje i datës 13 gusht 2002, faqet 4-5 të versionit në gjuhën angleze).

137. Aktgjykimi i kundërshtuar i shkallës së parë me këtë qartë thekson se *“vizita në vendin e krimit është përjashtuar si mundësi nga ana e trupit gjykues me qëllim të shmangies së përshtypjeve të gabuara. Është e vërtetë se trupi i mëhershëm gjykues kishte vizituar atë vend pasi kishte kaluar një periudhë katër vjeçare që nga koha kur kishin ndodhur këto ngjarje dhe kanë mundur që të formojnë gjykimin e tyre duke u bazuar në gjendjen tashmë të ndryshuar. Por ky argument, shkon në favor të vendimit për të mos vizituar përsëri burgun, dhe për të shfrytëzuar njohuritë dhe përshkrimin e fakteve dhe të fotografive të paraqitura nga trupi i mëhershëm gjykues gjatë vizitës së tyre (të*

cilat janë në shkresat e lëndës dhe të cilat janë paraqitur si prova materiale gjatë seancës së gjyqimit) [...]”.

138. Është e qartë se trupi ri-gjykues ka shfrytëzuar si dëshmi (dhe si prova materiale), dëshmitë dokumentuese të paraqitura gjatë procedurës 425/01. Ai nuk është mbështetur thjesht në gjetjet gjatë fazave të mëhershme të procedurës. Këto dëshmi dokumentuese janë bërë pjesë e kësaj procedure, pjesë të lëndës, gjatë seancave të ndryshme gjyqësore. Dhe gjykata ka vlerësuar dëshmitë dhe ka arritur tek përfundimet e saj në mënyrë korrekte.

C. Shkeljet substanciale të Ligjit Penal

139. Avokatët mbrojtës të të tre të akuzuarve kanë theksuar se Aktgjykimi i shkallës së parë ka shkelur ligjin penal. Në veçanti, **Luft Gashi** është gjetur përgjegjës në cilësinë e bashkë-kryerësit si dhe sipas Nenit 26 të KP të RSFJ-së (përgjegjësia penale e organizatorëve të asociacioneve kriminale), edhe pse, sipas mendimit të mbrojtjes, bashkëkryerja do ta mbulonte këtë përgjegjësinë e fundit.

Në të njëjtën kohë, Gjykata e shkallës së parë nuk kishte gjetur asnjë fjalë të vetme të arsyetimit lidhur me kushtet për bashkëkryerje siç është e përcaktuar me Nenin 22 të KP të RSFJ-së. Për më tepër, të akuzuarit ishin shpallur fajtorë për veprën penale të Krimeve të luftës sipas Nenit 142 të KP të RSFJ-së, por secili nga ta u dënuan veç e veç për dy, përkatësisht tri vepra penale, për të cilat në fund është shqiptuar një dënim unik.

Në fund vlen të përmendet se Gjykata e shkallës së parë kishte shkelur ligjin penal duke obliguar **Luft Gashin** të paguante dëmshpërblim prej 5.000,- € palës së dëmtuar M. S. , por pa u mbështetur në asnjë dëshmi përkatëse. Avokatët mbrojtës të **Nesir Mehmeti** dhe të **Risto Muratës** kanë deklaruar në përgjithësi se ligji penal ishte shkelur sepse klientët e tyre, edhe pse të pafajshëm, ishin dënuar për Krime të luftës, sipas Nenit 142 të KP të RSFJ-së.

I. Shkeljet e pohuara të Ligjit material me shpalljen e të akuzuarit fajtor

140. Lidhur me të akuzuarin i cili u shpall fajtor sipas Nenit 142 të KP të RSFJ-së, lidhur me Nenet 22, 24, 26 dhe 30 të KP të RSFJ-së dhe interpretimin e Nenit 142 të KP të RSFJ-së, përmendet ajo që është thënë më lart (A.II.5., faqe 25-29, 72 ff.). Për këtë arsye, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se nuk mund të konstatohet asnjë shkelje e ligjit penal në rastin në fjalë.

II. Pohimi mbi arbitraritetin gjatë caktimit të kërkesës për kompensim ndaj **Luft Gashit**

141. Mbrojtja e LPP Gashit përveç kësaj ka pretenduar se kompensimi i shumës prej 5.000,00 (pesëmijë) Euro e cila duhet t'i paguhet palës së dëmtuar M S , ashtu siç i është shqiptuar të akuzuarit nga Gjykata e shkallës së parë nuk është mbështetur në asnjë dëshmi përkatëse.

142. Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se Gjykata e shkallës së parë gjatë rigjykimit ka vendosur drejt kur ka caktuar shumën e dëmshpërblimit në fjalë, prandaj nuk kemi të bëjmë me asnjë shkelje të Nenit 103 të LPP-së.

Duhet të theksohet që gjykata ka caktuar dëmshpërblimin për dëme jo-monetare për shkak të vuajtjes së palës së dëmtuar si pasojë e rrahjes dhe për shkak të sjelljes së akuzuarit i cili ka shkelur të drejtat themelore të palës së dëmtuar, përkatësisht të drejtën e integritetit trupor dhe shëndetësor.

143. Përmendet aspekti juridik i paraparë me Ligjin mbi marrëdhëniet e detyrimeve të RSFJ-së, i cili natyrisht nuk është i zbatueshëm në rastin në fjalë, janë dy lloje të dëmshpërblimit dhe kështu mund të ndihmohet procedura edhe në lëndën penale në fjalë.

Sipas Nenit 195 të këtij Ligji, me qëllim të kompensimit të dëmeve monetare, shuma e dëmshpërblimit llogaritet sipas shpenzimeve mjekësore dhe humbjes së pagës, të cilat kandidati për dëmshpërblim i ka pasur. Kjo gjë nuk mund të lexohet nga Aktgjykimi i kundërshtuar, pavarësisht nëse Gjykata ka marrë parasysh apo jo këto çështje. Së paku, asnjë dokument mbi shpenzimet e vërteta të palës së dëmtuar nuk është në dispozicion në shkresat e lëndës, për çka Gjykata Supreme e Kosovës beson se shuma e dëmshpërblimit në fjalë nuk është caktuar në këtë mënyrë.

Megjithatë, përkundër dispozitave të Nenit 195, Neni 200 i Ligjit të njëjtë rregullon kompensimin e “dëmit jo-material” dhe përcakton që dëmshpërblim i barabartë paguhet “pavarësisht rregullimit të dëmit të pasurisë [...]” siç i referohet “edhe për dhimbjet fizike të përjetuara, për ankthin mendor të vuajtur si pasojë e uljes së aktiviteteve jetësore [...] si dhe për frikën e përjetuar [...]”.

144. Kjo po ashtu është në përputhje me detyrimin për sigurimin e ndreqjes personave të drejtat njerëzore të të cilëve janë abuzuar (në këtë rast përmes dispozitave specifike të përcaktuara me ligj të cilat fuqizojnë palën e dëmtuar për të kërkuar kompensim për dëmet jo-materiale), që dalin nga e drejta ndërkombëtare dhe nga konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të pranuar nga autoritetet kosovare në bazë të Nenit 22 të Kushtetutës.

145. Sa i përket shumës së dëmshpërblimit prej 5.000,00 Euro për shkak të humbjes së të gjithë dhëmbëve dhe për shkak të dhimbjes dhe frikës së përjetuar nga pala e dëmtuar, Gjykata Supreme konstaton se nuk është paraqitur as ankesë as propozim nga pala e dëmtuar apo nga Prokurori, prandaj ky aspekt nuk mund të kundërshtohet.

D. Vendimi mbi dënimin

146. Avokatët mbrojtës të të tre të akuzuarve kanë pretenduar se Aktgjykimi i shkallës së parë do të ishte i padrejtë, i pandershëm dhe i kundërligjshëm. Pasi që Aktgjykimi përmbante shkelje esenciale të procedurës penale, kishte vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë gjendjen faktike dhe po ashtu kishte shkelur ligjin penal, i vetmi vendim i ligjshëm do të ishte lirimi i të akuzuarve sipas Nenit 350, par. 1, nënpar. 3 i LPP-së.

147. Gjykata Supreme e Kosovës e konsideron kërkesën e mbrojtjes jomeritore dhe prandaj të pabazë. Pas asaj që u tha më lart në këtë Aktgjykim, është e tepërt të thuhet se nuk ka arsye për lirimin e të akuzuarve. Kjo gjykatë ka konstatuar se kështu nuk qëndron puna.

148. Sa i përket pjesës tjetër, vendimi mbi dënimin është tepër i drejtë; madje ky vendim gati sa nuk është i dobët dhe i ligshët. Gjykata e shkallës së parë në rigjykim posaçërisht ka marrë në konsideratë faktin që *“rrethanë lehtësuese është koha jashtëzakonisht e gjatë e gjykimit. Nga 21 korriku 2005 deri në fillimin e rigjyimit (07.07.09) dosjet e lëndës kanë pushuar pa u marrë askush me to. Të akuzuarit [...] iu nënshtruan masave të cilat ua kufizonin lirinë e lëvizjes, u desh të presin katër vjet për ta parë pjesën e tyre të përgjegjësive dhe për të pasur mundësinë për t'u deklaruar rreth rasteve të tyre. Kjo gjë është periudhë jashtëzakonisht e gjatë kohore gjatë së cilës [...] një nismë e pavendosur nëse jo edhe bishtnuese është ndërmarrë për rifillimin e gjykimit nga Divizioni për mbështetje ndërkombëtare gjyqësore i UNMIK-ut (faqe 31 e versionit në anglisht).*

Duhet të theksohet se gjyqtari i shkallës së parë me Aktgjykimin C. 425/2001 të datës 16 korrik 2003 i kishte shqiptuar dënimin prej dhjetë (10) burgim ndaj **Lotif Gashit**, përderisa **Nasir Mehmeti** kishte marrë trembëdhjetë (13) vjet burgim ndërsa **Rustem Mustata** gjithsej shtatëmbëdhjetë (17) vjet burgim.

149. Gjykata Supreme e Kosovës konteston në masë të madhe faktin nëse një vonesë dhe shtyrje e këtillë mund të justifikojë një ulje kaq të madhe të dënimit siç është bërë nga gjykata e shkallës së parë *“në maksimumin e spektrit”* (faqe 31 e versionit në gjuhën angleze). Pasi që vendimi i shkallës së parë gjatë rigjyimit përfundimisht mbështetet në parimin e gjykimit të drejtë siç përcaktohet me Nenin 6, par. 1 të Konventës evropiane mbi të drejtat dhe liritë themelore të njeriut (KEDNj), e cila parasheh kohëzgjatje të arsyeshme për çdo gjykim, duhet të theksohet se bazuar në gjykimin e Gjykatës evropiane për të drejtat e njeriut akoma nuk është gjetur përkufizimi i qartë i kohës së arsyeshme për disa kategori të caktuara të rasteve gjyqësore.

Për këtë arsye, udhëzimet mund të gjenden vetëm duke u mbështetur në disa lloje të praktikës gjyqësore dhe duke konsideruar specifikat, vështirësitë dhe natyrën komplekse të secilit rast në dritën e sjelljes së palëve përkatëse (*Meyer-Ladewig, Jens; Europäische Menschenrechtskonvention; Handkommentar; 2. Aufl.; Baden-Baden 2006; Artikel 6; Rz. 77 ff.*).

150. Sipas gjykimit të TPNJ-së (Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavi), Gjykata në rastin “Prokurori kundër personit Dragan Nikolic” (IT-94-2-S), ku i akuzuari ishte informuar mirë rreth aktakuzës qysh në vitin 1994 por që ishte arrestuar nga forcat përkatëse ndërkombëtare (SFOR) tek në vitin 2000, gjeti se “[...] kohëzgjatja jo proporcionale e procedurës mund të konsiderohet si faktor lehtësues në kuptimin e Nenit 6, par. 1, fjalia 1 e Konventës evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore e datës 4 nëntor 1950 (KEDNJ)” dhe se “[...] shkelja e së drejtës themelore të të akuzuarit për gjykim të drejtë dhe të shpejtë mund të arsyetohet [...] vetëm nëse vetë kryerësi ka qenë përgjegjës për shtyrjen e procedurës”.

151. Gjykata në veçanti i është referuar një vendimi të Gjykatës Supreme Federative Gjermane (1 StR 538/01), në të cilin ishte theksuar se për shkak të seriozitetit të krimeve të kryera në periudhën 1943-44 nga ana e një komandanti të një kampi të dikurshëm, rrethanat e jashtëzakonshme të cilat e zbusin fajin e të akuzuarit nuk mund të zbatoheshin dhe se i akuzuari, pasi u shpall fajtor, u dënua me burgim afatgjatë.

Në rastin e referuar, i akuzuari i cili vuante nga çrregullime në qarkullimin e gjakut, nga karcinoma në prostatë dhe si pasojë e trajtimit mjekësor nga osteoporoza që ka rezultuar me disfaginë dhe me nevojën që të ushqehet vetëm me ushqim të lëngshëm, u konstatua të jetë i aftë në aspektin mendor për t’u përballur me gjykimin. Gjykata Supreme Federative Gjermane në mënyrë të plotë iu ka referuar konstatimeve të Gjykatës së Apelit mbi përgjegjësinë penale të të akuzuarit në kohën kur ishin kryer krimet. Sa i përket dënimit, kjo gjykatë gjermane ka konstatuar se në rastin në fjalë nuk kanë mundur të zbatohen asnjë nga rrethanat lehtësuese.

Duke pasur parasysh kohën shumë të gjatë prej 56 vjetësh e cila ka kaluar që nga kryerja e krimit deri tek gjykimi, Gjykata duke iu referuar vendimeve të Gjykatës Supreme Federative Gjermane si dhe të Gjykatës Federative Kushtetuese, ka theksuar se “koha e arsyeshme” për procedurën gjyqësore siç përcaktohet me Nenin 6, par. 1 të KEDNJ-së çdo herë shkon në favor të të akuzuarve, sa herë që vonesa e procedurës shkaktohet nga autoritetet shtetërore. Megjithatë, nëse pasoja të tilla mund të shprijnë në rrethana lehtësuese, që mund të jetë puna në rastin tonë, gjithmonë do të kishte nevojë për një llogaritje të mirëfilltë dhe të përpiktë lidhur me uljen përkatëse të dënimit (*faqe 10 dhe 11 e versionit në gjuhën gjermane të vendimit përkatës*).

152. Gjykata e TPNJ-së prandaj ka konstatuar se në rastin e referuar “as kohëzgjatja ndërmjet kryerjes së krimit dhe gjykimit as koha e kaluar prej arrestimit deri në gjykim [nuk mund] të konsiderohet si faktor lehtësues”.

153. Edhe pse rasti në fjalë mund të jetë pakëz më ndryshe dhe vërtet një pjesë e kësaj shtyrjeje dhe vonese është shkaktuar pa ndikimin e të akuzuarve në procedurë, duhet të merret parasysh jo vetëm brutaliteti specifik i krimeve të kryera si dhe pozita e pambrojtur e viktimave në situatën e konfliktit të armatosur të asaj kohe dhe rrethanat e kryerjes së këtyre krimeve, por gjithashtu edhe fakti që të akuzuarit të cilët madje as që ishin paraburgosur gjatë gjithë asaj kohe por ishin liruar nga Gjykata Supreme, i kanë paraqitur shumë pengesa gjyqësorit gjatë kohës ndërmjet gjykimit të parë dhe rigjykimit.

154. Gjykata Supreme e Kosovës me këtë konstaton se Aktgjykimit të shkallës së parë i mungon çfarëdo lloj kalkulimi përkitazi me zbutjen e dënimit. Gjithashtu edhe serioziteti i krimeve të kryera nuk është analizuar as nuk është marrë fare parasysh në këtë pikë. Qasja me edukatë e të akuzuarve gjatë seancave të rigjykimit në gjykatën e shkallës së parë, siç pretendohet në Aktgjykimin e kundërshtuar nuk ka kurrfarë rëndësie në kontekstin tonë.
155. Gjykata e shkallës së parë në rigjykim ka shqiptuar dënime të ndara prej gjithsej nëntë (9) vjet burgim për **Lulif Gashin**, gjashtë (6) vjet për **Rrustem Mustafën** dhe 4.5 vjet për **Nazif Mehmetin** dhe pastaj ka formësuar një dënim unik prej gjashtë (6) vjet burgim për **Lulif Gashin**, tre (3) vjet për **Nazif Mehmetin** dhe katër (4) vjet për **Rrustem Mustafën**. Natyrisht, me këtë gjykata e shkallës së parë ka vendosur në përputhje me kornizën e dënimeve të mundshme të përcaktuara me ligjet përkatëse dhe nuk ka bërë ndonjë gabim serioz.
156. Megjithatë, Gjykata Supreme e Kosovës e ka të qartë se për shkak të faktit se Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar vetëm nga Mbrojtja por jo edhe nga Prokurori, prandaj ankesat janë parashtruar vetëm në dobi të të akuzuarve. Çështja tash është shndërruar në ndalimin me ligj të parimit *reformatio in pejus* siç përcaktohet me Nenin 378 të LPP-së, i cili parashih që “[nëse] është parashtruar ankesë vetëm në të mirë të akuzuarit, aktgjykimi nuk mund të ndryshohet në dëm të tij nga aspekti i vlerësimit juridik të veprës dhe i sanksioneve ligjore.”
157. Përveç kësaj, ky parimi i dytë është po ashtu edhe pjesë përbërëse e së drejtës ndërkombëtare, e cila njihet dhe pranohet nga Kosova. Posaçërisht vlen të përmendet se përderisa Statuti i TPNJ-së në Nenin e saj 25 nuk e ka njohur shprehimisht parimin *reformatio in pejus* prapëseprapë i njëjti zbatohet si parim i përgjithshëm juridik gjatë shqiptimit të dënimeve në TPNJ-së siç theksohet në “Mendimin mospajtuës të Gjyqtarit Schomburg lidhur me përgjegjësinë individuale penale të Mila Martiqit”, paragrafi 1 i të cilit mendim (lënda IT-95-11-A), parimi *reformatio in pejus* është i përcaktuar me Statut të Gjykatës Penale Ndërkombëtare (GjPN), i cili në Nenin 83, par. 2 në fund përcakton: “Kur vendimi mbi dënimin është ankimuar vetëm nga personi i dënuar, ose nga Prokurori në emër të atij personi, ai vendim nuk mund të ndryshohet në dëm të tij apo të saj.” Për më tepër, edhe Tribunali Penal Ndërkombëtar për Ruandën (TPNR) i referohet ndalimit të parimit *reformatio in pejus*, si parim që del nga parimi i drejtësisë (TPNR Dhoma e Apelit ICTR-00-55A-A: Prokurori kundër Tharcisse Muvunyi, Aktgjykimi i datës 29 gusht 2008, par. 170, fusnota nr. 382).
158. Natyrisht, sipas komenteve përkatëse, ekziston një përjashtim nga kjo rregull në rastet kur ankesa është dorëzuar vetëm në dobi të të pandehurit dhe aktgjykimi anulohet [...]. Këto komente në veçanti përcaktojnë: “Kur aktiviteti i të pandehurit për të cilin është shpallur fajtor është cilësuar me një aktgjykim të plotfuqishëm si disa vepra penale në bashkim ideal ose real, dhe Gjykata Supreme [...] miraton gjendjen faktike e cila është vërtetuar në procedurën e mëhershme, por ndryshon aktgjykimin e mëparshëm duke vërtetuar se bëhet fjalë vetëm për një vepër penale – Gjykata Supreme respekton vetëm

dënimin unik të shqiptuar me aktgjykimin e plotfuqishëm dhe jo dënimet e caktuara në mënyrë individuale për veprat në bashkim.

Në këtë rast, fjalia nga aktgjykimi i Gjykatës Supreme mund të jetë më i ashpër sesa dënimet e caktuara individualisht nga gjykatat e shkallës më të ulët, por nuk mund të jetë ky dënim më i ashpër sesa dënimi unik i cili është shqiptuar me aktgjykimin e plotfuqishëm” (Gjykata Federative (e RSFJ-së), Kzs 18/79 e datës 26 prill 1979; cituar nga Branko Petric; Komentet për Ligjin mbi procedurën penale; 1986; Botimi i dytë; Gazeta Zyrtare e RSFJ-së; Beograd; Neni 378; pika 12; faqe 199).

159. Rasti në fjalë futet në këtë kategori, ka pasur mundësi për Gjykatën Supreme të Kosovës për t'i rritur dënimet e ndara siç u janë shqiptuar të akuzuarve nga Gjykata e shkallës së parë në rigjykim, duke pasur parasysh se vepra penale e Krimeve të luftës kundër popullsisë civile, sipas Nenit 142 të KP të RSFJ-së do të konsiderohej vetëm si një vepër (e zgjeruar) penale pavarësisht se sa vepra të ndara janë kryer dhe siç rekomandohet edhe me komentet e autorit Ljubisa Lazarevic siç është përmendur edhe më herët në këtë Aktgjykim.

Megjithatë, përkundër faktit se kjo Gjykatë nuk ndan pikëpamjen rreth cilësimit juridik të Nenit 142 të KP të RSFJ-së si një vepër e zgjeruar penale, se rritja e dënimeve të ndara të cilat u janë shqiptuar të akuzuarve nga Gjykata e shkallës së parë do të kishte fare ndonjë efekt, pasi që nuk mund të bëhen ndryshime sa i përket dënimit unik të shqiptuar nga gjykata e shkallës së mëhershme.

E. Përfundimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

160. Për arsyet e përmendura më sipër, Gjykata Supreme përfundon se Ankesat kundër Aktgjykimit të shkallës së parë gjatë rigjykimit (P 526/2009) janë pjesërisht të bazuara dhe prandaj pranohen dhe lënda dërgohet prapa për rigjykim për Pikën 8 të Aktgjykimit përkatës.

161. Bëhet fjalë për atë që është theksuar më lart lidhur me dobësitë e Aktgjykimit të kundërshtuar për formalitetet e pjesës hyrëse si dhe të dispozitivit.

Materialisht, Gjykata e rigjykimit do të merr dhe do të vlerësojë të gjitha provat përkatëse të cilat lidhen me Pikën 8.

162. Sa i përket dënimit, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se duhet të respektojë parimin e ndalimit të *reformatio in pejus* për shkak të faktit se vetëm Mbrojtja ka parashtruar ankesa në emër të dhe në dobi të të akuzuarve.

Në këtë drejtim, theksohet se mbështeten dënimet e ndara ashtu siç u janë shqiptuar të akuzuarve nga Gjykata e rigjykimit për kryerjen e krimeve nën Pikat 5 dhe 14 të Aktgjykimit të kundërshtuar, e të cilat janë dënime me burgim të shqiptuar kundër **Leif**

Gashi për krimet e kryera nën Pikën 14 prej dy (2) vjet dhe nën Pikën 5 prej dy (2) vjet, kundër ~~Rosten Mustafës~~ për krimet e kryera nën Pikën 5 prej dy (2) vjet dhe kundër ~~Nazif Mehmetit~~ për krimet e kryera nën Pikën 5 prej një (1) vit e gjashtë (6) muaj burgim.

Për këtë arsye, Gjykata e rigjyimit tash – duke pasur parasysh gjetjet e saj lidhur me Pikën 8 të Aktgjyimit të kundërshtuar – do ta formulojë dhe do ta shqiptojë një dënim të ri unik për secilin nga të akuzuarit, i cili nuk mund të jetë më i lartë sesa i dënimi i mëparshëm, për shkak të ndalimit të parimit *reformatio in pejus*.

Megjithatë, kushtet për llogaritjen e dënimit dhe rrethanat lehtësuese siç janë përmendur në kapitullin E të këtij Aktgjykimi do të merren parasysh sa më shumë që një gjë e tillë të jetë e mundur.

163. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme e Kosovës vendos lidhur me Ankesat e Mbrojtjes si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ap.-Kz. Nr. 89/2010

Anëtar i kolegjit:

Charles L. Smith III.

Anëtar i kolegjit:

Martti Harsia

Anëtare e kolegjit:

Nesrin Lushta

Anëtare e kolegjit:

Emine Mustafa

Kryetar i kolegjit:

Gerrit-Marc Sprenger



Procesmbajtës

Sampsä Hakala